

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5823
E mërkurë, 10 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Nënshkruhet
marrëveshja 2.5 milionë
euro për digjitalizimin e
legjislacionit | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ | FAQE 4-5



Reagimi i opozitës, refren i bajatshëm

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, përpjekjet e opozitës për ta organizuar mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë i ka vlerësuar refrene bajate për qytetarët. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se reagimi i subjekteve opozitare është si reaksion i

mungesës së alternativës së tyre. Lekaj ka thënë se pa pasur nevojë të bëhet qesharake, opozita le ta organizojë mocionin nëse i ka votat. Akuzat e LDK-së dhe të Vetëvendosjes për korrupsion ndaj tij, Lekaj i ka quajtur shpifje të cilat nuk duhet të merren seriozisht. Sipas Lekajt, me ardhjen e tij në krye të kësaj ministrie i janë hapur dyert drejtësisë për ta bërë punën e vet



POZITA DHE OPOZITA,
TË PAJTIMIT SE KUVENDI NUK
ËSHTË DUKE FUNKSIONUAR | F. 3

POLICIA PËR TRI JAVË
SHQIPTOI 33 GJOBA NË
AUTOSTRADËN 'ARBËR
XHAFERI' | F. 5

350 MIJË EURO PAJISJE
TË REJA PËR KLINIKËN
E OFTALMOLOGJISË | F. 7

MINISTRI BYTYQI PËRKRAH
NUMRIN E RITJES SË
STUDENTËVE NË FAKULTETIN
E MJEKËSISË | F. 6

EKONOMI

APOSTOLOVA: KOSOVA DUHET
T'I SHTOJË PËRPJËKJET
KUNDËR EKONOMISË
JOFORMALE | F. 9

LLUKA: KOSOVA KA MARRË
HAPA KONKRETË DREJT
TRANSFORMIMIT DIGJITAL
RAJONAL | F. 8

SPORT

KARATEISTËT KRENOHEN ME
MEDALJET, PARALAJMËRON
REZULTATE EDHE
NË BOTËROR | F. 16



BISEDË ME ARKITEKTIN RRON BEXHETI, I CILI FITOI ÇMIMIN
E PARË NË ARKITEKTURË NË QYTETIN E ROMËS

Projekti i arkitektit shqiptar Rron Bexheti fiton çmimin e parë në Romë | FAQE 12-13



Arkitekti Rron Bexheti nga Gjilani, i cili jeton në Suedi dhe studion në Universitetin e Arkitekturës në Lund, është shqiptari që ofron zgjidhje për krizën e strehimit në Romë. Ai me pro-

jektin e tij që ka përgatitur së bashku me dy kolege të këtij universiteti "Jeta e murit - bashkëbanimi në murin Aurelian" ka zënë vendin e parë në garën ndërkombëtare të arkitekturës.

Rroni në një bisedë për gazetën "Epoka e re" ka folur rreth këtij projekti dhe konkurrencës në këtë garë. Gjithashtu, ka dhënë edhe mesazh për ruajtjen e arkitekturës në Kosovë

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Bullgaria u bën thirrje Kosovës dhe Serbisë të negociojnë

SARAJEVË, 9 KORRIK - Kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borisov, tha se Serbia dhe Kosova duhet të ulen dhe të merren vesh për disa çështje.

Ai i bëri komentet në kuadër të samitit të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, që po mbahet në Bosnjë.

Borisov tha se taksa, të cilën Kosova e ka vendosur ndaj mallrave nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, i komplikon gjërat, por ka theksuar se, edhe

Bullgaria me Turqinë kanë probleme të caktuara, por që përfaqësuesit e të dyjave vendeve mbajnë takime.

Kryeministri i Bullgarisë, tha gjithashtu se, nuk i ka të qarta kritikën të cilat ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić, i kishte bërë në drejtim të tij.

Ditë më parë, kryeministri bullgar kishte thënë se ministri i Jashtëm i Spanjës, Josep Borrell, i emëruar si shef i politikës së Jashtme të BE-së, duhet të përfaqësojë qëndrimin e të gjithë

bllokut, pavarësisht se Spanja nuk e njeh pavarësinë e Kosovës.

Ndaj këtij vlerësimi, pati reaguar Dačić, duke thënë se deklarata e kryeministrit bullgar është "paturpësi".

Pas kësaj përplasjeje, të dyja vendet ftuan ambasadorët përkatës në bisedime.

Ministria e Jashtme e Bullgarisë njoftoi se ambasadori serb në Sofje u ftua në një takim për shkak të komenteve të ministrit Dačić. Disa orë më pas, edhe



Serbia ftoi të ngarkuarin me punë të Bullgarisë në Beograd, për bisedime në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Meta i kërkon Bosnjës që ta njohë pavarësinë e Kosovës

Presidenti Ilir Meta, në Samitin për Bashkëpunim të vendeve të Evropës Juglindore që po mbahet në Sarajevë ka thënë se tani është koha e duhur që Bosnjë e Hercegovina të bëjë edhe një hap para për ta pranuar realitetin që Kosova është një shtet i pavarur dhe sovran

PRISHTINË, 9 KORRIK - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, në Samitin për Bashkëpunim të vendeve të Evropës Juglindore që po mbahet në Sarajevë, i ka bërë thirrje Bosnjë e Hercegovinës që të bëjë hapa para për të pranuar realitetin e Kosovës shtet të pavarur.

Meta ka thënë se Kosova është detyruar që të mos marrë pjesë në një organizim të tillë, pasi që në thirrjet që janë dërguar nuk është trajtuar si shtet i pavarur, duke drejtuar kështu kritika drejt vendeve pjesëmarrëse.

"Si mund të pretendojmë për bashkëpunim të suksesshëm rajonal, kur disa përfaqësues që janë pjesëmarrës në Samit, punojnë për t'i përjashtuar disa shtete nga përfitimet e këtyre iniciativave rajonale", ka thënë Meta.

Presidenti shqiptar i ka bërë thirrje Bosnjë e Hercegovinës që të avancojë me qëndrimin e saj, dhe ta pranojë Kosovën si shtet të pavarur.

"Tani është koha e duhur që

Bosnjë e Hercegovina të bëjë edhe një hap para për ta pranuar realitetin që Kosova është një shtet i pavarur dhe sovran. Respektimi i fqinjëve është thelbësor për vendet e Ballkanit Perëndimor", ka thënë Meta.

Sipas tij këto organizime rajonale e forcojnë dialogun e brendshëm mes vendeve të rajonit dhe se po kontribuojnë edhe në gjendjen e përgjithshme të sigurisë, duke përmendur këtu arritjen e marrëveshjes ndërmjet Greqisë dhe Maqedonisë Veriore për emrin.

Meta thotë se një marrëveshje e tillë ka qenë një përparim i madh për stabilitetin e rajonit.

Për presidentin e Shqipërisë zgjidhja e problemeve bilaterale është një gjë shumë e rëndësishme për rrugën drejt integriteteve evropiane, duke thënë se ka nevojë për reforma në vendet e rajonit.

Ndërkohë, kryeministri shqiptar, Edi Rama, ka vendosur që në shenjë solidarizimi me Kosovën,



të mos marrë pjesë në këtë Samit të Organizuar në Bosnjë.

Presidenti Ilir Meta, ka vizituar selinë e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal në Sarajevë, ku është pritur nga Majlinda Bregu.

Meta përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se pati kënaqësinë të jetë presidenti i parë shqiptar që viziton selinë e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal në Sarajevë, dhe njëkohësisht të

bisedojë me shqiptaren e parë në krye të kësaj organizate të rëndësishme, Majlinda Bregu.

Ai ka thënë se Bregu është duke bërë një punë të shkëlqyer për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe përshpejtimin e proceseve integruese të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka bërë me dije se është takuar në Sarajevë me presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, me të cilin biseduar për raportet

ndërshtetërore dhe për të ardhmen e Ballkanit dhe Evropës. "Kënaqësi të takoja sot në Sarajevë, presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdogan. Marrëdhëniet tona të shkëlqyera tradicionale kanë një të ardhme mjaft premtuese. Mirënjohës për peshën e jashtëzakonshme që Turqia mban për të mbrojtur Ballkanin dhe Evropën nga emigracioni i paligjshëm", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".

Mbërrin në Shkup ambasadorja e re e ShBA-së, Kate Byrnes

Shkup, 9 korrik - Ambasadorja e re e ShBA-së Kate Byrnes ka arritur në Maqedoninë Veriore, e cila në Ambasadën e ShBA-së në Shkup është pritur nga ushtruesja e kësaj detyre deri tani, Micaela Schëitzer-Bluhm. Byrnes është diplomat karriere, veterane me përvojë 24-vjeçare. Deri tani ka punuar si këshilltare për marrëdhënie me opinionin në Ambasadën e ShBA-së në Madrid, ish-përfaqësues civil në

Departamentin e Shtetit në grupin operativ Baston/Broniko në aeroportin Xhalalabad-Afganistan dhe këshilltar për marrëdhënie me opinionin në Misionin e ShBA-së në NATO.

Byrnes ka magjistruar në Universitetin "George Town" në Uashington. Ajo flet gjuhën spanjolle, hungareze dhe turke, ka njoftuar Zhurnal.

Nga shtatori 2017 punon në pozitën zëvendës-ambasadore

në Ambasadën e ShBA-së në Athinë.

Kate Marie Byrnes ishte zëvendës shef i misionit të ShBA-së në OSBE. Pikërisht nga Vjena, në disa raste, ka transmetuar qëndrimin e administratës amerikane në kontekst të krizës politike.

Ajo pritet të mbajë mandat pesëvjeçar në Maqedoni kurse të martën ajo u është drejtuar të punësuarve në ambasadë.



Pozita dhe opozita, të pajtimit se Kuvendi nuk është duke funksionuar

Përfaqësuesit e partive në pushtet dhe të atyre në opozitë shprehin të njëjtin mendim se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk është duke e luajtur mjaftueshëm rolin përfaqësues, ligjvënës dhe mbikëqyrës. Ata kanë thënë se në këtë legjislativë Kuvendi në vazhdimësi është karakterizuar me mungesë të kuorumit që, për rrjedhojë, ka dështuar miratimi i shumë ligjeve dhe rezolutave. Madje, sipas opozitarëve, mbarëvajtja e punës së Kuvendit është për keqardhje

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 9 KORRIK - Përveç shoqërisë civile, edhe pozita dhe opozita janë të pajtimit se Kuvendi i Kosovës nuk është duke e luajtur rolin e vet kushtetues. Sipas përfaqësuesve të partive në pushtet dhe atyre në opozitë, legjislativi gjatë kësaj periudhe është ballafaquar me mungesë të kuorumit, që ka ndikuar në marrjen e vendimeve të ndryshme.

Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka vlerësuar se mungesa e kuorumit është problemi më i madh me të cilin ballafaqohet Kuvendi. Në këtë kontekst ai ka thënë se Kuvendi nuk po arrin ta luajë mjaftueshëm rolin përfaqësues, ligjvënës e as mbikëqyrës. "Mungesa e kuorumit është problemi më i madh me të cilin ballafaqohet Kuvendi, meqenëse tash e sa kohë nuk ka shumicë parlamentare në Kuvend dhe, si pasojë, nuk arrin ta luajë mjaftueshëm rolin e tij përfaqësues, ligjvënës e as mbikëqyrës. Vetëm në muajin maj, për shkak të mungesës së kuorumit, kanë dështuar tetë mbled-

hje", ka deklaruar Kryeziu për gazetën "Epoka e re".

Edhe ish-kryeparlamentari i Kosovës, aktualisht kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka thënë se në vendin tonë asnjë institucion e as Kuvendi nuk është duke e luajtur rolin e vet kushtetues. Ai ka vlerësuar se zhvillimet e fundit janë treguesi më i mirë se ka rënë spiralla e përfaqësimit dhe niveli i përgjegjësisë dhe i debatit. "Jo vetëm Kuvendi, por me këtë kulturë politike që është formësuar në Kosovë në përgjithësi e me kulturën e përfaqësimit në veçanti, asnjë institucion, as Kuvendi, nuk mund ta luajë rolin e vet kushtetues. Kjo që e kemi parë që sa kohë është treguesi më i mirë se spiralla e përfaqësimit ka rënë shumë dhe bashkë me të ka rënë edhe niveli i përgjegjësisë dhe i debatit, madje jo vetëm në Kuvend, por edhe përgjithësisht në shoqërinë shqiptare", është shprehur Krasniqi, duke shtuar se debati i fundit në Kuvend për Luginën e Preshevës u zhvillua për farsë patriotike e jo për zgjidhje politike", ka deklaruar Jakup Krasniqi për gazetën "Epoka e re".

Edhe deputetja e Kuvendit të



Republikës së Kosovës, njëherësh kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se mbarëvajtja e punës së Kuvendit është për keqardhje. Sipas saj, kualiteti apo përmbajtja e seancave lë shumë për të dëshiruar. Kusari-Lila ka theksuar se në vazhdimësi në muajt e fundit ka pasur kërkesa për seanca të jashtëzakonshme, përderisa pozita nuk ka arritur propozimet e veta t'i kalojë për shkak të mungesës së deputetëve të pozitës. "Mbarëvajtja e punës së Kuvendit është për keqardhje. Ani pse sa i përket numrit të ligjeve që kemi miratuar dikush mund të thotë se kemi bërë si duhet. Besoj se kualiteti apo përmbajtja e seancave lë shumë për të dëshiruar. Në vazhdimësi në muajt e fundit

ka pasur kërkesa për seanca të jashtëzakonshme, përderisa pozita nuk ka arritur propozimet e veta t'i kalojë për shkak të mungesës së deputetëve të pozitës. Ndërsa ekziston një pakënaqësi e madhe në nivel vendi në raport me agjendën e përgjithshme të shtetit. Vërehet se kjo qeveri nuk i ka fokus proceset zhvillimore dhe ekziston një huti e përgjithshme. Krejt ajo që mund të themi, si për Kuvendin ashtu edhe për qeverinë, është se kur do të shkojmë në zgjedhje të kemi një ndryshim të strukturës legjislativë dhe qeverisëse", ka thënë Kusari-Lila për gazetën "Epoka e re".

Por për dallim nga ish-kryeparlamentari Jakup Krasniqi dhe deputetja Mimoza Kusari-Lila, deputeti i Kuvendit të Kosovës

nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Daut Haradinaj, ka thënë se, pavarësisht prej vështirësive, një pjesë e madhe e ligjeve kanë gjetur mbështetjen e shumicës së deputetëve. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re", se bojkoti opozitar nuk është gjë tjetër veçse një formë kundërshtimi nga opozita, pasi temat kombëtare pothuajse janë duke u trajtuar në formën më të mirë të mundshme. "E rëndësishme është që një pjesë e madhe e ligjeve kanë gjetur mbështetjen e shumicës së deputetëve. Bojkoti opozitar nuk është gjë tjetër veçse një formë kundërshtimi nga opozita, pasi temat kombëtare pothuajse janë duke u trajtuar në formën më të mirë të mundshme", është shprehur deputeti Daut Haradinaj.

Qendra e Studentëve, me konviktet më të mira në rajon

PRISHTINA, 9 KORRIK (ER) - Qendra e Studentëve e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" tashmë është shndërruar në një shtëpi të ngrohtë për të gjithë studentët nga Kosova dhe vendet e rajonit. Kjo qendër ka bërë me dije se kanë punuar shumë që konviktet të ofrojnë jetë cilësore për studentët. "Ditët më të bukura të studimeve jetojnë në konvikte. Pikërisht për këtë ne kemi siguruar një ambient të ngrohtë, dhoma komode, salla të leximit, ujë të ngrohtë në çdo kohë. Vetëm në vitet e fundit menaxhmenti i kësaj qendre ka bërë shumë investime. Investimet e bëra kapin shifra milionëshe, e tëra kjo që studentëve t'u ofrohen kushte për një

jetë sa më cilësore. Kemi punuar shumë që ky ambient të bëhet shtëpia juaj e dytë. Ne çdo vit presim mijëra studentë dhe çdo vit jemi munduar të sjellim risi dhe mënyra që ta bëjmë çdo gjë më të lehtë. Interesimi i studentëve për të jetuar jetën studentore në konvikte është shumë i madh. Gjithsecili që i plotëson kriteret mund të bëhet banues në këtë qendër", është thënë në njoftimin e Qendrës së Studentëve. Sipas këtij njoftimi, në kuadër të Qendrës së Studentëve funksionojnë me kapacitet të plotë tetë konvikte. Po sipas këtij njoftimi, është bërë me dije se Qendra e Studentëve është 24 orë në monitorim nga kamerat dhe se niveli i sigurisë është tejet i lartë.



Flet për "Epokën e re", Pal Lekaj

Reagimi i opozitës,

Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, përpjekjet e opozitës për ta organizuar mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë i ka vlerësuar refrene bajate për qytetarët. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se reagimi i subjekteve opozitare është si reaksion i mungesës së alternativës së tyre. Lekaj ka thënë se pa pasur nevojë të bëhet qesharake, opozita le ta organizojë mocionin nëse i ka votat. Akuzat e LDK-së dhe të Vetëvendosjes për korrupsion ndaj tij, Lekaj i ka quajtur shpifje të cilat nuk duhet të merren seriozisht. Sipas Lekajt, me ardhjen e tij në krye të kësaj ministrie i janë hapur dyert drejtësisë për ta bërë punën e vet

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, u është kundërpërgjigjur akuzave të opozitës për korrupsion. Ai ka thënë se akuzat e opozitës ndaj tij janë shpifje dhe nuk duhen marrë seriozisht. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Lekaj ka deklaruar se akuzat e subjekteve opozitare janë si pasojë e frikës që e ka kapluar nga puna e madhe e qeverisë Haradinaj. "Unë shpesh e kam potencuar se këto sulme të njëpasnjëshme janë vetëm shpifje, asgjë tjetër. Janë pasojë e frikës që e ka kapluar nga puna e madhe që po bëhet në qeverinë Haradinaj. Prandaj, si të tilla, nuk duhet as të trajtohen seriozisht", ka thënë Lekaj. Ai ka bërë me dije se tani në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit i është hapur dera drejtësisë që të

veprojë lirshëm. Sipas tij, LDK-ja është në panik nga frika se tani drejtësia do t'ia nxjerrë në shesh të palarat që i ka lënë në këtë ministri. "Mbase mund të kenë frikë se u dalin të palarat që i kanë lënë jo vetëm në Departamentin e Patentshoferëve, por në mbarë ministrinë, tash kur më në fund i janë hapur dyert drejtësisë të veproje lirshëm, pa presion, në këtë institucion. Unë për dy vjet sa jam ministër kam punuar fuqishëm drejt reformimit të pajisjes me patentshoferë. Vetëm pak ditë më parë lansuam edhe 'e-testimin' që askush nuk pati guxim ta bëjë më parë. Unë e ripërsëris qëndrimin tim se drejtësia i ka dyert e hapura dhe duhet ta çojnë procesin deri në fund", ka thënë ai.

Ministri Lekaj ka folur edhe për mocionin e opozitës ndaj qeverisë Haradinaj. Ai ka thënë se pretendimet e opozitës për këtë mocion tashmë janë bërë refrene



Policia për tri javë shqiptoi 33 gjoba në autostradën "Arbër Xhaferi"

PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Policia e Kosovës, konkretisht Njësia për Kontroll të Autostradave, me qëllim të parandalimit të aksidenteve në autostradën "Arbër Xhaferi", ka hartuar dhe ka zbatuar një plan operativ. Policia ka njoftuar se disa pjesëmarrës në trafik, në autostradën "Arbër Xhaferi", më saktësisht në urën mbi lumin "Lepenc", për kuriozitet dhe për shkak të bukurive që ofron kjo urë, kanë ndaluar me automjetet e tyre në

shiritat emergjentë dhe kanë zbritur nga automjetet ku në shumë raste kanë bërë edhe fotografi të ndryshme, me ç'rast është rrezikuar siguria e tyre dhe e pjesëmarrësve të tjerë në trafik. Në këtë kontekst, me qëllim të shtimit të sigurisë në autostradë, policia ka bërë me dije se gjatë tri javëve të shkuara ka shqiptuar gjithsej 33 tiketa në këtë lokacion, prej tyre 28 tiketa ndaj shoferëve për ndalje në autostradë dhe pesë për lëvizjen

e këmbësorëve në autostradë. "Policia e Kosovës apelon dhe kërkon nga qytetarët në përgjithësi dhe drejtuesit e automjeteve në veçanti që t'i respektojnë rregullat e trafikut rrugor, me theks të veçantë të mos bëjnë shkelje të rregullave të qarkullimit në autostradë sepse po rrezikojnë jetën e tyre dhe të tjerëve. Policia do t'i ndëshkojë të gjithë ata që bëjnë shkelje të tilla", është thënë në njoftimin Policisë së Kosovës.



refren i bajatshëm



të bajatshme për qytetarët. "Nuk kemi pse të frikësohemi prej çfarëdo skenari që mund të mendojë opozita. Reagimet e tyre janë refren i bajatshëm për qytetarët si reaksion i mungesës së alternativës. Puna jonë ka folur tashmë prandaj, pa pasur nevojë të bëhen qesharakë, le të organizojnë mocionin, ndërsa ne jemi të gatshëm për zgjedhje, edhe sikur ato të ndodhin nesër. Megjithatë, mandatin do ta përmbyllim siç parashihet në Kushtetutë", është shprehur Lekaj.

"Epoka e re": Z. Lekaj, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje së fundi kanë drejtuar shumë akuza në drejtim tuajin. Pse?

Lekaj: Unë shpesh e kam potencuar se këto sulme të njëpasnjëshme janë vetëm shpifje, asgjë tjetër. Janë pasojë e frikës që i ka kapluar nga puna e madhe që po bëhet në qeverinë Haradinaj. Prandaj, duke qenë të tilla, nuk duhet të trajtohen seriozisht.

"Epoka e re": Akuzat e tyre kanë të bëjnë edhe për rastin e fundit, ku janë arrestuar disa zyrtarë të ministrisë suaj, të cilët dyshohen për korrupsion në lidhje me lëshimin e patentshoferëve. Cila është përgjegjësia juaj në këtë rast?

Lekaj: Mbase mund të kenë frikë se u dalin të palarat që i kanë lënë jo vetëm në Departamentin e Patentshoferëve, por në mbarë ministrinë, tash kur, më në fund, i janë hapur dyert drejtësisë të veprojë lirshëm, pa presion, në këtë institucion. Unë, për tashmë dy vjet sa jam ministër, kam punuar fuqishëm për reformimin e pajisjes me patentë shoferë. Vetëm pak ditë më parë lansuam edhe "e-testimin", që askush nuk pati guxim ta bëjë më parë. Unë e ripërsëris qëndrimin tim se drejtësia i ka dyert

e hapura dhe duhet ta çojë procesin deri në fund.

"Epoka e re": Përveç liderit të LDK-së, edhe disa zyrtarë të tjerë të kësaj partie i kanë shtuar kritikuar ndaj jush dhe qeverisë Haradinaj. Këto akuza po e dëmtojnë mundësinë e bashkëpunimit në të ardhmen në mes të këtyre dy subjekteve politike?

Lekaj: Asnjëherë nuk është vonë për ta kuptuar se je gabim, edhe partitë opozitare mund të pendohen dhe të kërkojnë bashkëpunim.

"Epoka e re": Zyrtarët opozitarë çdo ditë e më tepër po shprehin optimizëm se mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë do të ketë sukses. Sa besoni se ky synim i opozitës do të arrihet dhe këtë vit të kemi zgjedhje?

Lekaj: Kjo është një shaka e vazhdueshme prej së cilës opozita në vazhdimësi nuk po e kursen popullin. Sikur të ishin aq seriozë, për aq herë sa e kanë përmendur mocionin, tashmë do të ishin mbajtur edhe zgjedhjet.

"Epoka e re": Së fundi po diskutohet ideja e zgjerimit të bashkëpunimit të subjekteve opozitare, në mënyrë që në mandatin e ardhshëm të kemi një qeveri të përbërë vetëm nga subjektet politike që tani janë në opozitë. A i frikësoheni këtij skenari?

Lekaj: Nuk kemi pse të frikësohemi prej çfarëdo skenari që mund të mendojë opozita. Reagimet e tyre janë refrene të bajatshme për qytetarët si reaksion i mungesës së alternativës. Puna jonë ka folur tashmë prandaj, pa pasur nevojë të bëhen qesharakë, le të organizojnë mocionin, ndërsa ne jemi të gatshëm për zgjedhje, edhe sikur ato të ndodhin nesër. Megjithatë, mandatin do ta përmbyllim siç parashihet në Kushtetutë.

Ymeri: Procesi i rekrutimit të noterëve duhet të hetohet

PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Visar Ymeri, ka kritikuar procesin e rekrutimit të noterëve të rinj. Ai ka kërkuar që ky proces të hetohet nga organet përgjegjëse të Kosovës dhe të vlerësohet nga partnerët e Ambasadës së Zvicrës.

Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se procesi i tanishëm i rekrutimit të noterëve të rinj mund ta komprometojë

sistemin e noterisë. "Procesi i rekrutimit të noterëve të rinj që organizohet nga Ministria e Drejtësisë duhet të hetohet nga organet përgjegjëse të Republikës së Kosovës dhe të vlerësohet nga partnerët e Ambasadës së Zvicrës, të cilët kanë merita për ndërtimin e sistemit noterial në Kosovë. Procesi i tanishëm i rekrutimit të noterëve të rinj ka prirje ta komprometojë sistemin e noterisë që u ndërtua me kredi-

bilitet të brendshëm dhe të jashtëm, kryesisht falë ekspertëve zviceranë të Institutit për Studime të Larta Noteriale (I-H-N)", ka shkruar Ymeri, duke shtuar se pavarësia politike e sistemit të noterisë është parakusht për garantimin e një sistemi funksional dhe bashkëkohor noterial që i shërben shtetit të së drejtës, përforcimit të aparatit gjyqësor dhe konsolidimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës.



Nga shtatori nis themelimi i Gjykatës Komerciale

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se kanë filluar përgatitjet për ta nisur themelimin e Gjykatës Komerciale e cila do jetë adresë unike e drejtësisë që përfshinë biznesin. "Nga shtatori i këtij viti do të procedojmë bazën ligjore që i vë themelin kësaj gjykatë si dhe që i siguron fizionominë, profesionalizimin dhe përmasat e nevojshme që i nevojiten drejtësisë komerciale", ka thënë ministri Tahiri



ka thënë ministri Tahiri. Projekti i Gjykatës Komerciale është duke u zhvilluar mbi bazën e të gjeturave dhe rekomandimeve të procesit të rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit, reformë

gjithëpërfshirëse e udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë. Akterët e përfshirë në rishikimin funksional - gjyqësori, shoqëria civile, odat ekonomike dhe bizneset - përkrahin themelimin e një

gjykate komerciale që përfshinë në një ombrellë kompetencat e Departamentit Ekonomik si dhe të Divizionit Fiskal të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

EPOKA E Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e Programit të USAID-it për Drejtësi Komerciale, me të cilët ka biseduar për hapat konkretë që mundësojnë realizimin e njërës prej projekteve më të mëdha kapitale të sistemit të drejtësisë, themelimin e Gjykatës Komerciale.

Ministri Tahiri ka bërë me dije se për më shumë se 15 muaj ka mbajtur konsultime të ngushta me komunitetin e biznesit, partnerët zhvillimorë dhe mekanizmat ndërinstitucionalë dhe tashmë janë duke u ndërmarrë hapat konkretë për materializimin e këtij projekti. Ministri Tahiri ka vlerësuar se procedurat e stërzgjatura,

mungesa e gjyqtarëve të specializuar dhe mungesa e një adrese të vetme për zgjidhjen e kontesteve ka ulur besimin e bizneseve dhe investitorëve të huaj në drejtësi dhe se këto probleme duhet të marrin një përgjigje adekuate. "Bizneset janë bartëse të zhvillimit, punëzënies dhe rritjes së potencialit socio-ekonomik të shoqërisë sonë. Rrjedhimisht, ato duhet të kenë vëmendjen që e meritojnë edhe nga këndvështrimi i drejtësisë. Kam filluar përgatitjet intensive për ta nisur themelimin e Gjykatës Komerciale e cila do të jetë adresë unike e drejtësisë që përfshinë biznesin. Nga shtatori i këtij viti do ta procedojmë bazën ligjore që i vë themelin kësaj gjykatë si dhe që i siguron fizionominë, profesionalizimin dhe përmasat e nevojshme që i nevojiten drejtësisë komerciale",

Ministri Bytyqi, pro rritjes së numrit të studentëve në Fakultetin e Mjekësisë



PRISHTINË, 9 KORRIK (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shqipëri Bytyqi, ka pritur të martën në takim ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismaili dhe dekanen e Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", prof. dr. Suzana Manxhuka-Kërliu. Në takimin e ftuar nga ministri Bytyqi u bisedua rreth

kërkesës lidhur me mundësinë e rritjes së numrit të studentëve për regjistrim në Fakultetin e Mjekësisë në UP për vitin e ri akademik 2019/2020.

Ministri Bytyqi ka shprehur gatishmëri që kjo kërkesë të realizohet për faktin se është një politikë me interes kombëtar dhe në funksion të kësaj MASHT-i është duke

marrë veprimet e nevojshme, duke parë të gjitha mundësitë ligjore që kjo kërkesë të jetësohet, gjithnjë duke u bazuar edhe në vendimet e AKA-së.

Ministri Bytyqi dhe Ismaili në fund të këtij takimi vlerësuan se është e nevojshme që të rritet numri i studentëve në mënyrë që të përmbushen kërkesat dhe nevojat e qytetarëve për shërbime mjekësore.

Ministrja Hoxha priti në takim lamtumirës ambasadorin e Francës

Prishtinë, 9 korrik (ER) - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka pritur të martën në takim lamtumirës ambasadorin e Francës në Kosovë, Didier Chabert, të cilin e ka falënderuar për bashkëpunim dhe përkrahje të fuqishme të procesit integruar. Ministrja Hoxha vuri në dukje se ambasadori Chabert, por edhe diplomacia franceze, ka dëshmuar përkrahjen e proceseve të cilat po i kalon Kosova, në veçanti reformat nga agjenda evropiane, zbatimi i MSA-së si dhe përkrahja për integrimin e

Kosovës në organizatat ndërkombëtare. "Ne kemi pasur mbështetje të plotë nga ju, z. ambasador Chabert, për proceset të cilat po i kalon Kosova, në veçanti përkrahjen për liberalizimin e vizave. Koha dhe aktualiteti politik është i tillë që kemi pritur më shumë në këtë drejtim nga Franca megjithatë, faktorët e brendshëm dhe pas zgjedhjeve në Parlamentin Evropian, presim të rikthehet në fokus lëvizja e lirë dhe largimi i çdo dyshimi për rrugën tonë integruar", ka potencuar ministrja Hoxha. Ambasadori Chabert ka vlerë-

suar bashkëpunimin me institucionet e Kosovës, në veçanti me Ministrinë e Integritimit, duke ditur dhe njohur prioritetet e Kosovës për integrimin brenda vlerave evropiane. Po ashtu, ambasadori Chabert e ka falënderuar ministrën Hoxha duke rikonfirmuar përkrahjen e tij si një mik i dëshmuar i Kosovës, përkrahës i fuqishëm për integrimin sa më të shpejtë të Kosovës me vlerat integruar euroatlantike.

Ministrja Hoxha ka theksuar se ambasadori Chabert ka ndërthurar një miqësi dhe besim në mes



të dy vendeve, duke e quajtur këtë miqësi si vlerë për vendin tonë, miqësi e cila do të bëhet

edhe më e madhe në të ardhmen, duke qenë rrugë dhe synim i përbashkët.

Nënshkruhet marrëveshja 2.5 milionë euro për digjitalizimin e legjislacionit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, dhe ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, Per Strand Sjaastad's, kanë nënshkruar të martën marrëveshjen e bashkëpunimit për zbatimin e projektit për digjitalizimin e legjislacionit dhe harmonizimin gjuhësor të tij, i financuar nga shteti norvegjez në vlerë prej 2.5 milionë eurosh



**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Per Strand Sjaastad's, me të cilin ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për zbatimin e projektit për digjitalizimin e legjislacionit dhe për harmonizimin gjuhësor të tij, i financuar nga shteti norvegjez në vlerë prej 2.5 milionë eurosh. Duke falënderuar ambasadorin Sjaastad's dhe shtetin norvegjez për mbështetjen e vazhdueshme për Kosovën, kryeparlamentari Veseli ka thënë se me anë të digjitalizimit të legjislacionit qytetarët e Kosovës, mediat, organizatat e shoqërisë civile, partitë politike, institucionet e ndryshme do të kenë qasje të lehtë edhe të menjëhershme

në ligjet e Kosovës. Veseli ka shtuar se ky projekt, i modelit "Lowdata", si një nga modelet më të avancuar të digjitalizimit të ligjeve, të zbatuar me dekada të tëra në shtetin e Norvegjisë, shënon hapin e parë të E-Qeverisjes në Kosovë. "Harmonizimi gjuhësor është komponenti i dytë i rëndësishëm i këtij projekti. Ky harmonizim është tejet me rëndësi për shoqërinë tonë shumetnike, ngaqë përmes tij evitohen mospërputhjet mes ligjeve në gjuhë të ndryshme. Në këtë drejtim jemi duke punuar së bashku me partnerët tanë në një fjalor zyrtar tregjuhësh, shqip-serbisht-anglisht. Shumica e buxhetit për realizimin e këtij projekti të rëndësishëm do të jetë donacion nga shteti i Norvegjisë, ndërsa pjesërisht projekti do të financohet edhe nga buxheti ynë", ka theksuar kryeparlamentari Veseli. Ai ka theksuar

se nga sot demokracia parlamentare e Kosovës është më afër trendëve bashkëkohorë të legjislacionit dhe transparencës ndaj qytetarëve. Ambasadori norvegjez Per Strand Sjaastad's ka pohuar se financimi i këtij projekti është konfirmim i mbështetjes së shtetit që ai përfaqëson për

reformat në Kosovë. "Ky projekt do të jetë një mekanizëm shumë i rëndësishëm dhe i përdorshëm për të gjithë ligjvënësit, për profesionistët ligjorë, prokurorët dhe avokatët, si dhe të gjithë qytetarët e thjeshtë në këtë vend", është shprehur ambasadori Sjaastad's, duke shtuar se kon-


tributi i Norvegjisë në këtë projekt do të jetë rreth 2.3 milionë euro. Ai e ka falënderuar kryeparlamentarin Veseli për bashkëpunimin e ngushtë me shtetin norvegjez dhe ka vlerësuar lart rolin e tij për demokratizimin dhe transparencën e Kuvendit të Kosovës.

350 mijë euro pajisje të reja për Klinikën e Oftalmologjisë

**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 KORRIK - Klinika e Oftalmologjisë (Syve), pas 37 vjetëve pa investime, këtë vit është pajisur me pajisje moderne në vlerë 350 mijë euro, investim i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Këto pajisje e kanë shndërruar këtë klinikë në klinikë moderne dhe kanë mundësuar rritjen e gamës së shërbimeve shëndetësore. Me rastin e pranimit të këtyre pajisjeve, këtë klinikë e kanë vizituar ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, dhe drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu. Ata kanë parë punën që po bën stafi shëndetësor në sallat operative, pas furnizimit me pajisje të reja mjekësore, e që janë lehtësim për punën e tyre dhe krijojnë kushte më të mira për trajtim të pacientëve. Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se furnizimi i kësaj klinike me aparaturën e nevojshme i rrit kapacitetet e

saj për diagnostikimin dhe operimin e sëmundjeve të syve. Ai rikujtoi se deri me blerjen e këtyre pajisjeve, vetëm për oftalmologji nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore ishin shpenzuar mbi 1 milion euro në vit, meqë deri sot janë trajtuar jashtë institucioneve publike shëndetësore. Tani këto shërbime pacientët do t'i marrin edhe në QKUK. Ministri Ismaili ka bërë me dije se me këtë investim po bëhet transformimi i kësaj klinike, pasi që deri tani ishte një klinikë e cila për shumë vjet ka varfëruar xhepin e qytetarëve dhe buxhetin e shtetit. Drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, me këtë rast ka thënë se këto investime janë duke u bërë në vazhden e investimeve që po bëhen në institucionet shëndetësore, në varësi të ShSKUK-së, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve shëndetësore për pacientët. "Jemi duke investuar në aspektin bazik në infrastrukturë dhe shumë pajisje mjekësore që kanë munguar prej që ekziston kjo klinikë. Kjo mundëson metoda të reja kirurgjike dhe



edukim për stafin dhe pacientët që të mos shkojnë jashtë klinike", ka thënë Sejdiu. Drejtori i Klinikës së Oftalmologjisë, Adem Miftari, ka theksuar se nga viti 1982 nuk ishte investuar në këtë klinikë. Duke shprehur falënderimin për investimin e bërë,

ai ka premtuar se tash e tutje, me ardhjen e pajisjeve të reja, nuk do të ketë më nevojë për t'i dërguar pacientët jashtë klinikes, sepse shumica e shërbimeve, si diagnostike ashtu edhe terapeutike, do të kryhen në Oftalmologji. Disa nga pajisjet e blera për herë të

parë janë mikroskop operativ për operimin e segmentit të pasmë të syrit, Cross-Linking për trajtimin e patologjive të kornesë së syrit, Optical Coherence Tomography për diagnostifikimin e sëmundjeve të retinës dhe pajisje të tjera.

Lluka: Kosova ka marrë hapa konkretë drejt transformimit digjital rajonal

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, po qëndron në Bruksel, ku po merr pjesë në dialogun mes vendeve të Ballkanit perëndimor dhe atyre të Bashkimit Evropian rreth Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK), takim ky i ftuar nga komisionarja për Teknologji dhe Ekonomi Digjitale, Mariya Gabriel. Ai ka përshëndetur lansimin e agjendës digjitale për vendet e Ballkanit Perëndimor, duke theksuar se Kosova është e përkushtuar ta avancojë bashkëpunimin regjional me synim të krijimit të një ekonomie digjitale rajonale. "Kosova ka mirëpritur lansimin e agjendës digjitale për vendet e Ballkanit Perëndimor nga Komisioni Evropian të mbajtur në Sofje të Bullgarisë në kuadër të asamblesë digjitale vitin e kaluar. Ne jemi të përkushtuar të punojmë së bashku me vendet e Ballkanit perëndimor dhe vendet e BE-së në mënyrë që të bëjmë tranzicionin e regjionit në ekonomi digjitale dhe të përfitojmë nga ky transformim digjital, në mënyrë që të kemi rritje më të shpejtë ekonomike, më shume vende pune dhe shërbime më të mira për qytetarët tonë", është shprehur ministri Lluka.

Kreu i MZHE-së gjithashtu ka thënë se Qeveria e Kosovës konsideron sektorin e TIK-ut si një nga sektorët më të rëndësishëm sa i përket zhvillimit ekonomik dhe të transformimit struktural në një shoqëri dhe ekonomi të bazuar në dije. Ai ka thënë se Kosova është duke punuar me seriozitet për përshpejtimin e hapave drejt këtij transformimi përmes zhvillimit infrastrukturor të qasjes dhe përdorimit të TIK-ut, forcimin e kapitalit njerëzor në mënyrë që të maksimizohen përfitimet që vijnë nga teknologjia dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin e industrisë së teknologjisë ku përmes eksportit të TIK-ut krijohet një mundësi e madhe e rritjes së numrit të punësuarve, sidomos të rinjtë dhe gratë. Po ashtu, ministri Lluka ka treguar se Qeveria e Kosovës ka përshtatur legjislacionin e saj me atë të BE-së për adaptimin e rregullimit të mbledhjes së të dhënave për infrastrukturën e komunikimit elektronik.

Ai ka treguar se është kompletuar përshtatja e direktivës së BE-së për uljen e kostove të komunikimit elektronik, që do të fillojë në gusht të vitit 2019. Gjithashtu, Lluka ka theksuar se Kosova ka lansuar procesin e përshtatjes së Direktivës së



Sigurisë së Rrjetës dhe Informacionit si dhe ka zhvilluar Ligjin për identifikimin elektronik dhe shërbimeve të sigurisë në transaksionet elektronike.

Në fjalimin e saj, komisionarja për Teknologji dhe Ekonomi Digjitale, Mariya Gabriel, ka thënë se nga aprovimi i agjendës digjitale vitin e kaluar në Sofje kanë arritur ta aprovojnë marrëveshjen e parë të roamingut dhe ka kërkuar nga ministrat e rajonit që të rritet bashkëpunimi për krijimin e tregut digjital. "Nga agjenda digjitale e aprovuar në Sofje të vitit të kaluar ne kemi arritur që brenda një viti ta kemi mar-

rëveshjen e parë të roamingut si dhe priten shumë fonde të BR-së të shfrytëzohen nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të cilat kanë synim të ndihmojnë këto vende për arritjen e objektivave të ekonomisë digjitale. Unë kërkoj nga ministrat e rajonit, të cilët mbulojnë këtë sektor, që ta rrisin bashkëpunimin në mënyrë që të krijohet një treg i përbashkët digjital, duke eliminuar procedurat e panevojshme burokratike", ka thënë Gabriel.

Në termat e interkonektivitetit regjional, ministri Lluka ka treguar arritjet e Qeverisë së Kosovës në këtë aspekt. "Në aspektin e roamingut ne jemi të

kënaqur që është arritur marrëveshja në mes vendeve të Ballkanit Perëndimor e cila tani ka filluar të zbatohet. Gjithashtu, sa i përket interkonektivitetit regjional, ne jemi duke e ndjekur hap pas hapi iniciativën e rrjetëzimit digjital të vendeve të Ballkanit të Bankës Botërore me synim që të rritet bashkëpunimi në mes të regjionit tonë me synim transformimin digjital. Në vazhdim të shumë projekteve, ne vlerësojmë se projekti 'Gratë në teknologji' është njëra nga më të suksesshmit i cili është zbatuar në shumë vende të Kosovës dhe ka dhënë praktika shumë të mira", ka deklaruar Lluka.

AShNA dhe ALBCONTROL nënshkruajnë memorandum mirëkuptimi

PRISHTINË, 9 KORRIK (ER)-Menaxhmenti i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (AShNA), i prirë nga drejtori Bahri Nuredini, ka pritur të martën në takim një delegacion të Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Shqipërisë "ALBCONTROL", në krye me drejtorin e Përgjithshëm Mina Kusta si dhe drejtorin e Divizionit për Siguri, Cilësi dhe Sigurim, Sokol Ruçi, me ç'rast edhe nënshkruan memorandum mirëkuptimi për krijimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit strategjik ndërmjet AShNA-së dhe ALBCONTROL-it.

Drejtori Bahri Nuredini ka njoftuar kreun e ALBCONTROL-it me planet dhe projektet që janë duke u realizuar dhe që priten të realizohen në të ardhmen në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. "Përmes këtij memorandum arrihet mirëkuptimi i të dy autoriteteve që ta ndihmojnë njëra-tjetrën për zbatimin e kërkesave ndërkombëtare të rëndësishme për fushën e

Shërbimeve të Navigacionit Ajror", ka thënë ai.

Ndërsa drejtori i Përgjithshëm i ALBCONTROL-it, Mina Kusta, ka shprehur gatishmërinë e tij që ta ofrojë ndihmën e ALBCONTROL-it dhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit në mes të AShNA-së dhe ALBCONTROL-it.

Qëllimi i këtij memorandum është që palët ta ndihmojnë njëra-tjetrën për zbatimin e kërkesave ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil - ONAC, Bashkimit Evropian - BE, EUROCONTROL dhe kërkesave të tjera, ashtu si konsiderohen të rëndësishme për fushën e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Në fund u realizua edhe një vizitë në ambientet e AShNA-s, me ç'rast drejtori Bahri Nuredini ka falënderuar delegacionin e ALBCONTROL-it për bashkëpunimin dhe ndihmën e ofruar deri më tani.



Apostolova: Kosova duhet t'i shtojë përpjekjet kundër ekonomisë joformale

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 KORRIK - Nën udhëheqjen e ministrit të Financave, Bedri Hamza, njëherësh edhe koordinatori nacional për Programin për Reforma në Ekonomi, është mbajtur të martën takimi lansues për Programin për Reforma në Ekonomi 2020-2022, në të cilin ka marrë pjesë edhe udhëheqësja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ministrat përkatës, përfaqësues të ministrive të përfshirë në këtë proces, përfaqësues të Komisionit Evropian, ambasade të vendeve anëtare të BE-së si dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe sektorit privat.

Në fjalën e tij ministri i Financave, Bedri Hamza, ka theksuar se në këtë proces institucionet që janë pjesë e kësaj trupe kanë bërë një punë të madhe në forcimin dhe avancimin e këtij dialogu.

Ai ka thënë se vlerësimet që kanë pranuar vazhdimisht nga Komisioni Evropian kanë qenë mjaft pozitive. "Me këtë po dëshmohet se Kosova e kupton rëndësinë dhe rolin e procesit të qeverisjes ekonomike si një nga shtyllat kryesore të zgjerimit dhe si përgatitje për pjesëmarrjen eventuale në Semestrin Evropian", ka thënë Hamza. Ai ka kërkuar që të ketë zhvillim edhe më të madh në ngritje të kualitetit të dokumentit edhe në të ardhmen, ku Kosova si vend duhet t'i paraqesë zotimet për reformat e nevojshme struktur-



ore për t'i përmbushur kriteret ekonomike të cilat janë kërkesë kyçe për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe të cilat janë të përcaktuara me kriteret e Kopenhagës. "Ne duhet të demonstrojmë se zbatimi i reformave nuk prek qëndrueshmërinë financiare në periudhën afatmesme dhe të jenë të përballueshme për buxhetin dhe në këtë mënyrë të mundësojnë bazë solide për funksionim efektiv të ekonomisë në tregun afatgjatë", është shprehur

Hamza.

Ai ka theksuar se dialogu ekonomik dhe financiar ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, duke u bazuar në Programin e Reformës Ekonomike 2019-2021, ka nxjerrë dy dokumente bazë: vlerësimin e Komisionit Evropian dhe konkluzionet e përbashkëta të miratuara në kuadër të takimit ministror të datës 17 maj ku, sipas tij, të dy këto dokumente kanë vlerësuar gjendjen reale të ekonomisë në

Kosovë, por edhe kanë prezantuar sfidat kryesore, adresimi i të cilave do t'i eliminonte disa barrierat kyçe për rritje ekonomike dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Ministri Hamza në fjalën e tij ka përmendur edhe sfidat si aktivizimi ekonomik dhe punësimi, sidomos i femrave dhe të rinjve, ndërlidhja mes arsimit dhe tregut të punës, formatizimi i ekonomisë, shfrytëzimi i potencialit të burimeve të ripërtëritshme dhe kursimeve

të energjisë, si dhe hapja e plotë e tregut të energjisë.

Ministri Hamza e përmblylli fjalën e tij me dy kërkesa për të pranishmit. "E para ne si vend duhet të bëjmë prioritizimin e duhur për t'i adresuar barrierat kyçe ekonomike të identifikuar. E dyta ka të bëjë me zbatimin, duke siguruar përzgjedhjen e prioriteteve të duhura dhe ndërlidhjen e mirë të tyre me kornizën makrofiskale, që të sigurohemi për zbatim të mirëfilltë të reformave strukturore", ka thënë Hamza.

Ndërsa shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, vuri në dukje faktin se duke marrë pjesë në stërvitjen e ERP, Kosova dhe Ballkani Perëndimor pasqyrojnë procesin e Semestrin Evropian. "Qeverisja ekonomike iu përket bazave të politikës së zgjerimit, prandaj është prioritet kryesor në dialogun tonë me Kosovën. Është e rëndësishme që Kosova t'i shtojë përpjekjet për luftën kundër ekonomisë joformale, ruajtjen e disiplinës fiskale, reformat energjetike dhe përmirësimin e kushteve të tregut të punës për gratë dhe të rinjtë në veçanti. Zbatimi i këtij udhëzimi për politika kërkon jo vetëm përpjekje në emër të organeve zbatuese, por edhe angazhim të fortë politik. Vetëm kjo mund të sjellë ndryshime dhe përparim real në terren, duke mbështetur përfundimisht zhvillimin e sektorit privat dhe rritjen e mundësive të punësimit për popullin e Kosovës", ka thënë Apostolova.

Përfaqësues të OAK-ut takojnë deputetën Kusari-Lila, diskutojnë për tema të ekonomisë

Prishtinë, 9 korrik (ER) - Përfaqësues nga Oda e Afarizmit e Kosovës (OEK) janë takuar të martën me deputetën e Kuvendit të Kosovës, Mimoza Kusari-Lila. Qëllimi i takimit ishte njoftimi reciprok në mes të palëve, gjendja aktuale lidhur me problemet ligjore si Ligji i Punës, pushimi i lehonisë, Ligji për Minerale dhe sektori i energjisë dhe çështje të tjera të cilat po ndikojnë në ngritjen ekonomike.

Zyrtarja e OAK-së, Rreze Cana, ka falënderuar deputetën Kusari-Lila për pritjen në takim, duke prezantuar para saj problemet nëpër të cilat po kalojnë bizneset kosovare, të cilat kanë nevojë të domosdoshme për mbështetjen e tyre. Anëtarë i Bordit të OAK-ut, Hamdi Malushaj, ka njoftuar

Kusari-Lilën më gjerësisht për klimën jo të favorshme të të bërit biznes në Kosovë, duke theksuar se problemet ligjore janë faktori kryesor në ngecjen e zhvillimit ekonomik në vend, si rezultat i mosharmonizimit të ligjeve me njëra-tjetrën dhe moszbatimit të tyre.

Një tjetër çështje me rëndësi e cila u diskutua në këtë takim ishte edhe pushimi i lehonisë, që ligji aktual po krijon pengesa për zhvillimin dhe avancimin e femrës dhe faktin se shteti nuk është duke i trajtuar njëjtë gratë si në sektorin publik, po ashtu edhe në atë privat. Për këtë fakt, përfaqësuesit e OAK-së kërkuar që deputetët ta përkrahin kërkesën e bizneseve që shteti ta marrë përsipër pushimin e lehonisë edhe në sektorin privat.

Në fund të takimit Malushaj ka



kërkuar mbështetje në kërkesat e OAK-së, odë kjo e cila përfaqëson denjësisht bizneset, pa

të cilat nuk ka zhvillim ekonomik të vendit. Ndërsa deputetja Mimoza Kursari-Lila

u shpreh e hapur për çdo bashkëpunim me OAK-në në të ardhmen.

Nënshkruhet marrëveshja për ta shndërruar në zonë turistike pendën e Livoçit

GJILAN, 9 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Fisnik Reçicën, përfaqësues i "Swisscontact"-it, për të promovuar, mbështetur dhe bashkëfinancuar zhvillimin e zonës turistike rreth Pendës së

Livoçit, njëkohësisht edhe krijimin e kushteve për ta rritur fluksin e turistëve në këtë pjesë. Kjo marrëveshje synon që krahas zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në Komunën e Gjilanit, të ndikojë edhe në zhvillimin e sektorit privat dhe rritjen e punësimit. Faza e

parë është studimi i fizibilitetit për çka është një angazhim i përbashkët me dinamikë të shtuar në mënyrë që më pas të vazhdohet edhe me fazat e tjera për inkuadrimit dhe funksionalizimin e kësaj zone, në hapësirë të veçantë turistike.



Në fshatin Shupkovic të Mitrovicës të premtën vihet gurthemeli i xhamisë

MITROVICË, 9 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës, Agim Bahtiri, të martën ka pritur në takim drejtuesit e Bashkësisë Islame të Mitrovicës, imamin Irfan Krasniqi dhe sekretarin Izet Feka, me të cilët ka biseduar lidhur me projektin e ndërtimit të xhamisë në fshatin Shupkovic.

Drejtuesit e BI-së gjatë këtij takimi e njoftuan kryetarin Bahtiri lidhur me projektin për ndërtimin e xhamisë, donacion ky i mbështetur nga organizata humanitare "Qatar Charity". Me këtë rast kryetari Bahtiri ka ofruar mbështetjen e tij të



plotë për ndërtimin e kësaj xhamie, pasi edhe komuna i ka ofruar me kohë të gjitha dokumentet e nevojshme në përputhje me kornizën ligjore dhe lejet e nevojshme për ndërtimin e kësaj xhamie.

Po ashtu, kryetari Bahtiri ka bërë me dije se vënia e gurthemelit të kësaj xhamie do të bëhet të premtën dhe u ka bërë thirrje qytetarëve ta përkrahin këtë iniciativë të ndërmarrë nga Bashkësia Islame në Mitrovicë, pasi xhamia është shtëpi e Zotit dhe si të tillë duhet ta pranojmë të gjithë,

Ndërsa kryetari i Bashkësisë Islame të Mitrovicës, Irfan Krasniqi, ka thënë se është e rëndësishme për tërë qytetin ndërtimi i kësaj xhamie si një shtëpi e Zotit, ku të rinjtë do të marrin dije dhe besim që të jetojnë në paqe dhe harmoni me të gjithë të tjerët ashtu siç e ka pasur traditë gjithmonë Mitrovica.

Në fund kryetari Bahtiri u tha përfaqësuesve të BI-së të Mitrovicës se ai dhe komuna gjithmonë kanë qenë për bashkëpunim të mirë me BI-në dhe kështu do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Aliu u premtën bashkëpunim 50 kryetarëve të fshatrave dhe zonave urbane

FERIZAJ, 9 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu dhe drejtoresha së Administratës së Përgjithshme, Aurora Ramadani, kanë pritur në takim kryetarët e sapozgjedhur të fshatrave dhe zonave urbane të kësaj komune. Pasi ka uruar kryetarët e rinj, Aliu është zotuar për bashkëpunim me secilin prej tyre. Agim Aliu tha se ky takim ka karakter solemn dhe është shprehje e vullnetit institucional për bashkëpunim më të mirë të komunitetit në zonat

ku përfaqësojnë. "Ju jeni adresë e shumë kërkesave dhe të gjitha ato kërkesa ju i sillni tek unë, që t'i zgjidhim këto probleme të cilat i shqetësojnë qytetarët" ka thënë Aliu, duke shtuar se ky takim është vendosur pak ditë para fillimit të dëgjimeve për hartimin e buxhetit dhe diskutimit publik të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB). Në procesin e zgjedhjes së kryetarëve të fshatrave dhe zonave urbane kanë marrë pjesë rreth 9 000 qytetarë.



Edhe pak ditë të lëshohen në qarkullim rrugët 'Ilaz Kodra' dhe '18 Qershori' në Skenderaj

Skenderaj, 9 korrik (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije të martën se kanë mbetur edhe pak punë për riparimet e nevojshme përg-

jatë rrugëve "Ilaz Kodra" dhe "18 Qershori", që qarkullimi i automjeteve të kthehet në normalitet dhe pa ndonjë vështirësi. "Ndërkohë që nëpër fshatrat tona

ka filluar me hov puna për realizimin e projekteve kapitale, kujdes po u kushtojmë edhe rrugëve brenda qytetit tonë", ka thënë kryetari Jashari.

Asfaltohet rruga Obiliq-Plemetin-Prilluzhë

OBILIQ, 9 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të martën ka inspektuar nga afër asfaltimin e rrugës R220, segmenti Obiliq-Plemetin-Prilluzhë. Ministri Lekaj ka thënë se kjo

rrugë lidhë komunat e komunitet mes vete dhe ndikon në zhvillimin ekonomik të Obiliqit dhe të Vushtrrisë. Ai ka ritheksuar përkushtimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit që, krahas zhvil-

limit të projekteve të reja, t'i mirëmbajnë në vazhdimësi rrugët ekzistuese. Rruga R220, segmenti Obiliq-Plemetin-Prilluzhë, ka gjatësi prej tri kilometrash dhe po realizohet në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve.



Berlini: Qeveria e re greke ta respektojë Marrëveshjen e Prespës

BERLIN, 9 KORRIK - Gjermania pret që Qeveria e re greke të ketë rol konstruktiv në procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Maqedoninë e Veriut, bëri me dije zëdhënësi i Qeverisë gjermane, Stefan Seibert. "Kjo është një arritje që mundëson normalizimin e marrëdhënieve mes

Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë dhe sinjerisht shpresojmë se qeveria e re greke në mënyrë konstruktive do të marrë pjesë në këtë proces pozitiv", tha ai. Kancelarja Merkel në urimin drejtuar Micotaqisit thotë se pret me padurim të takohen dhe se shpreson për

bashkëpunim të afërt miqësor dhe vazhdimin e marrëdhënieve të partneritetit mes Gjermanisë dhe Greqisë. Merkeli falënderoi edhe ish-kryeministrin Aleksis Cipras sepse "në shumë vite sfiduese, gjithmonë kanë arritur një bashkëpunim të besueshëm dhe të respektuar".




Washingtoni paralajmëron Iranin

Zëvendëspresidenti Mike Pence tha se Irani nuk duhet ta ngatërrojë qëndrimin e përmbajtur amerikan me mungesë të vendosmërisë amerikane duke shtuar se ShBA-ja dhe ushtria e saj janë të gatshme t'i mbrojnë interesat, personelin dhe shtetasit amerikanë në rajon

WASHINGTON, 9 KORRIK - Zyrtarë të lartë amerikanë thonë se Irani nuk duhet të verë në provë durimin e Amerikës, ndërsa prodhon materiale bërthamore në sasi dhe cilësi që i kalojnë kufijtë e vendosur në marrëveshjen ndërkombëtare bërthamore të vitit 2015. Reagimi vjen ndërkohë që inspektorët e Agjencisë Ndërkombëtare për Energjinë Atomike vërtetuan se Irani shkeli kufirin e përcaktuar në marrëveshjen bërthamore e cila kishte për synim që Teherani të mos prodhonte armë bërthamore. Irani thotë se do të shkelë marrëveshjen bërthamore të vitit 2015 pasi Shtetet e Bashkuara u tërhoqën nga ajo vitin e kaluar. Kjo shkaktoi reagime të ashpra nga zëvendëspresidenti Mike Pence. "Irani nuk duhet ta ngatërrojë qëndrimin e përmbajtur amerikan me mungesë të vendosmërisë amerikane. Shpresojmë për më të mirën, por Shtetet e Bashkuara dhe ushtria jonë janë të gatshme t'i mbrojnë interesat, personelin dhe shtetasit amerikanë në rajon. Do të vazhdojmë ta kundërshtojmë influencën malinje të Iranit, do ta vazhdojmë presionin ndaj ekonomisë së tyre dhe nën presidentin Donald Trump, Amerika nuk do të lejojë kurrë Iranin të ndërtojë armë bërthamore", tha Pence. Këshilltari i Sigurisë Kombëtare, John Bolton, bëri një paralajmërim të ngjashëm. "Do ta vazhdojmë shtimin e presionit ndaj regjimit iranian derisa ai ta braktisë programin e armëve bërthamore dhe u jep fund aktiviteteve të dhunshme në Lindjen e Mesme, përfshirë veprimet dhe mbështetjen për terrorizmin

në botë", tha Bolton. Një drejtues i lartë ushtarak iranian tha se vendi i tij nuk po kërkon luftë me asnjë vend. Ai tha se Irani po u bënë thirrje vendeve nënshkruese të marrëveshjes bërthamore që të gjejnë një rrugëdalje nga sanksionet paralizuese amerikane, përfshirë eksportin e rëndësishëm të naftës. Bashkimi Evropian dhe Rusia shprehën shqetësime lidhur me veprimet iraniene për pasurimin e uranimit. Rusia, gjithashtu, ka fajësuar Shtetet e Bashkuara për tërheqjen nga marrëveshja bërthamore vitin e kaluar.



ShBA-ja i shet Tajvanit pajisje ushtarake



WASHINGTON, 9 KORRIK - Departamenti Amerikan i Shtetit miratoi një kërkesë të Tajvanit për të blerë pajisje ushtarake me vlerë rreth 2.2 miliardë dollarësh. Marrëveshja përfshin 108 tanke Abrams, 250 raketa kundërajrore Stinger dhe mbi 1 500 raketa anti-tank.

Pentagoni tha se paketa nuk do të ndryshojë baraspeshën ushtarake në rajon. Marrëveshja e mundshme e ka zemëruar Kinën, rivalen e Tajvanit. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme, Geng Shuang, i bëri thirrje ShBA-së të martën që "ta anulojë menjëherë marrëveshjen" duke thënë se ajo shkel rëndë parimin e një Kine të vetme dhe ndërhyr rëndë në punët e brendshme të Kinës dhe minon sovranitetin dhe interesat e sigurisë të Pekinit. Ai tha se Kina i ka paraqitur ankesa zyrtare ShBA-së nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Turqia urdhëron arrestimin e mbi 170 shërbyesve ushtarakë

ANKARA, 9 KORRIK - Turqia urdhëroi arrestimin e 176 shërbyesve ushtarakë për lidhje të dyshuara me rrjetin që Ankaraja e fajëson për përpjekjen për grushtshtet, tre vjet më parë. Në njoftimin e prokurorisë thuhet se në mesin e atyre që përballen me arrestim janë: një kolonel, dy nënkolonelë, pesë majorë dhe shtatë kapitenë. Operacioni përfshin ushtrinë, forcën ajrore dhe atë detare,

thuhet në njoftim. Ankaraja thotë se kleriku mysliman Fethullah Gulen e ka organizuar përpjekjen për puç në Turqi, më 15 korrik të vitit 2016. Gulen, i cili jeton në Shtetet e Bashkuara, e mohon përfshirjen. Në përndjekjen trevjeçare të autoriteteve, mbi 77 000 njerëz janë burgosur dhe rreth 150 000 shërbyes civilë dhe të tjerë janë

pushuar ose suspenduar nga puna. Aleatët perëndimorë të Turqisë dhe grupet e të drejtave të njeriut kanë kritikuar shkallën e përndjekjes, duke thënë se presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan e ka përdorur puçin e dështuar si pretekst për t'i heshtur kundërshtarët. Ankaraja ka thënë se veprimet e tilla janë të domosdoshme përballë shkallës së kërcënimeve për sigurinë.



Bisedë me arkitektin Rron Bexheti, i cili fitoi çmimin e parë në arkitekturë në qytetin e Romës

Projekti i arkitektit shqiptar Rron B

Arkitekti Rron Bexheti nga Gjilani, i cili jeton në Suedi dhe studion në Universitetin e Arkitekturës në Lund, është shqiptari që ofron zgjidhje për krizën e strehimit në Romë. Ai me projektin e tij që ka përgatitur së bashku me dy kolege të këtij universiteti "Jeta e murit - bashkëbanimi në murin Aurelian", ka zënë vendin e parë në garën ndërkombëtare të arkitekturës. Rroni në një bisedë për gazetën "Epoka e re" ka folur rreth këtij projekti dhe konkurrencës në këtë garë. Gjithashtu, ka dhënë edhe mesazh për ruajtjen e arkitekturës në Kosovë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 9 KORRIK - Njëzetepesëvjeçari nga Gjilani, Rron Bexheti, i cili që dy vjet jeton në Suedi dhe ka përfunduar vitin e parë të nivelit master në Universitetin e Arkitekturës në Lund, së fundi ka marrë pjesë, së bashku me dy kolege të këtij universiteti, Karin Frykholm dhe Lisa Fransson, në garën ndërkombëtare të arkitekturës "Sfida e jetesës kolektive në Romë". Në këtë garë ndërkombëtare, në

të cilën kanë marrë pjesë studentë nga e gjithë bota, Rron Bexheti dhe dy koleget e tij kanë fituar çmimin e parë me projektin e tyre "Jeta e murit - bashkëbanimi në murin Aurelian". Konkursi ka qenë në qytetin e Romës në Itali, në një qytet të rrethuar me histori të ndryshme, një civilizim që daton që nga vitet më të lashta. Me mbi 2 900 000 banorë Roma është edhe qyteti më i madh dhe më i populluar i vendit. Qyteti është i vendosur në pjesën qendrore-perëndimore të gadishullit italian, në lumin Tiber. Me gjithë këtë histori, fuqi ekonomike dhe



exheti fiton çmimin e parë në Romë

dendësi të madhe të qytetarëve, ditët e sotme është shumë e vështirë të gesh vendbanim në Romë, ndonjëherë e pamundur. Më të vështirë këtë fakt e bëjnë edhe çmimet marramendëse të apartamenteve. Këto kushte ekstravagante e bëjnë jetën shumë të vështirë për të rinjtë dhe studentët italianë dhe evropianë.

Konkursi "Rome Collective Living Challenge" përqendrohet

po në këtë fakt, gjetja e një zgjidhje të re për problemet e të rinjve romakë.

Rroni dhe dy koleget e saj, Karin dhe Lisa, kanë treguar se ky është bashkëpunimi i tyre i parë si ekip në këtë garë ndërkombëtare të arkitekturës. Ata kanë theksuar se interesi i përbashkët si ekip ka qenë të dalin fitues në këtë projekt dhe ia kanë arritur qëllimit.

Në intervistën dhënë pas marrjes së çmimit të parë, të tre studentët

Ai ka treguar se projekti i tyre synon murin Aurelian mbrojtës të Romës, i gjatë 19 kilometra, i ndërtuar në shekullin e tretë, si një gjenerator i stokut të ardhshëm të banesave të qytetit romak. "Projekti fokusohet të demonstrojë që muri mbrojtës Aurelian i ndërtuar nga perandori Aurelian nuk është vetëm strukturë defanzive historike, por shërben për të qenë përgjithmonë i dobishëm për qytetin romak dhe

një konkurs internacional arkitekturual", ka thënë Rroni.

Ai ka dhënë sqarime rreth projektit të tij "Jeta e murit - bashkëpunimi në murin Aurelian". "Muri Aurelian përpos që është mur statik brenda tij në pjesë të caktuara ekzistojnë hapësira ku në kohët e lashta ato hapësira janë përdorur si sirculacion të ushtarëve romakë dhe pozicionimin e tyre për mbrojtjen e territoreve romake, pra këto hapësira sado të

vogla, po shumë interesante dhe tashmë të harruara, janë regjeneruar nga projekti ynë dhe janë vënë në funksion. Prandaj, me plot kuptimin e fjalës, romakët modernë mund të jetojnë brenda atyre hapësirave.

Duke e adaptuar propozimin tonë me formën lineare të murit historik Aurelian, njësitë rezidenciale vendosen krah për krah dhe lidhen nga një hapësirë jetese komunale, kolektive", ka thënë Rroni.



kanë theksuar se pjesëmarrja në një garë të llojit tillë ishte e një rëndësie të veçantë.

Rroni ka inkurajuar të gjithë të rinjtë shqiptarë që të marrin pjesë në gara ndërkombëtare dhe ta tregojnë suksesin e tyre pasi, sipas tij, kjo është mënyra më e bukur për ta zhvilluar profesionin si arkitekt, duke mësuar nga projektet dhe nga bashkëpunimi ekipor mes njëri-tjetrit.

Rron Bexheti studimet bachelor i ka përfunduar në Universitetin "Beykent" në Stamboll. "Qëllimi ishte të krijohen vendbanime kolektive me cilësi të jetës së lartë, por me çmime të ulëta, si dhe të krijohet një mënyrë e jetesës të vetëqëndrueshme dhe eco-friendly (të mos dëmtohet ambienti që na rrethon). Përpos këtyre, konkursi kërkon ide inovative nga dizajnerë dhe arkitektë, si dhe firma - byro arkitekturale që të gjendet një zgjidhje jo e zakonshme ku ofrohet një mënyrë shumë e veçantë e jetesës. Kërkesa më të veçanta nga konkursi ishin që gjithçka të jetë me harxhime minimale të ndërtimit, ku propozimet duhet të jenë fleksibile dhe të jenë produktive në të njëjtën mënyrë në vende të ndryshme të qytetit romak", ka thënë Rroni për gazetën "Epoka e re".

zgjidhjes së problemit residencial të qytetarëve të Romës. Projekti ynë propozon njësi të konstruktura në mënyrë të thjeshtë nga materiali i drurit që mund të implementohen përgjatë pjesëve të paprekura në vende të ndryshme të strukturës historike, Murit Aurelian. Materialet dominante janë druri, xhami transparent dhe tela mbajtës nga materiali i çelikut", ka treguar Rron Bexheti. Ai ka shtuar se konkurrenca në këtë konkurs ka qenë jashtëzakonisht e fortë. "Shihet se çmimet dytësore kanë marrë firma të njohura romako-londoneze si dhe persona që kanë punuar dhe punojnë drejtpërdrejt me Norman Foster, një arkitekt që besoj se të gjithë ne e njohim, kurse çmime më të ulëta si honorable mentioning (Përmendje njeri) kanë marrë firma nga Brazili, Amerika, Rusia dhe Ukraina. Çmimin si vend të parë e bënë edhe më të veçantë arsyeja se ne jemi studentë të masterit në Universitetin Lund dhe kemi arritur të jemi të parët duke marrë parasysh që shumë firma profesionale kanë aplikuar për këtë konkurs. Projekti është bashkëpunim imi me dy kolege nga Universiteti Lund, Karin Frykholm dhe Lisa Fransson. Për ne kjo është pjesëmarrja e parë në

ARKITEKTURA NË KOSOVË, RRONI BËN THIRRJE QË TË RUHEN MONUMENTET HISTORIKE

Rron Bexheti si arkitekt ka folur edhe për arkitekturën në Kosovë. "Mendoj se ne si arkitekt kosovar dhe ndërtimtar duhet të mësohemi të ndërtojmë për qytetarët dhe për të gjithë shoqërinë, për ngritjen e cilësisë së jetës së tyre, e jo vetëm për një pjesë të shoqërisë. Kjo mund të arrihet në qoftë se fokusohemi në aspektin social të arkitekturës dhe se ne mund të bëjmë ndryshime të vërteta në jetën e njerëzve, e jo vetëm të fokusohemi në aspektin tipikal të arkitekturës dhe t'i harrojmë aspektet e tjera shumë të rëndësishme", ka theksuar Rroni. Ai

ka thënë se shqiptarët e duan kombin e tyre dhe historinë nëpër të cilën kanë kaluar.

Rroni ka bërë thirrje që të ruhen monumentet historike. "Ne shqiptarët jemi popull shumë vetëdashës, që është shumë tipar i mirë, e duam kombin tonë, historinë tonë, jetojmë me historinë tonë, ndoshta është koha ta vlerësojmë historinë e arkitekturës kosovare dhe shqiptare dhe jo ta shkatërojmë atë, çfarëdo që është, hapësira publike, ndërtesa të vjetra, duhet t'i vlerësojmë e jo t'i rrënojmë, duhet t'i restaurojmë dhe jo t'i shkatërojmë", ka thënë Rron Bexheti.




E jashtëzakonshme

Toka e "përpinë" makinën

Një vrimë gjigante u hap në tokë në Virginia duke hedhur një makinë rreth 6 metra më poshtë. Kalimtarët e habitur kanë filmuar çastin kur makina duket sikur "kollofitet" nga toka. Fatmirësisht, mjeti ishte i parkuar dhe brenda nuk ndodhej asnjë person. Pasi nxorën mjetin nga vrima e madhe, autoritetet thanë se do t'i marrin masat për ta rregulluar rrugën.



FOTO E DITES



Një pamje ajrore nga plazhi i Durrësit, i stërbushur me pushues në këto ditë të nxehta. Fotoja është publikuar nga LSA.

E rrallë

Gjyshi shpenzon 8 000 dollarë për ta ndërtuar shtëpinë e ëndrrave në majë të pemës

Një gjyq ka bërë realitet ëndrrën e nipërve dhe mbesave të tij duke ndërtuar një shtëpi në majë të pemës. Ai ndërtoi shtëpinë prej druri në kopshtin e pasmë të shtëpisë. Terry Meredith



shpenzoi 8 000 dollarë për krijimin e shtëpisë pesë metra mbi tokë dhe që mban deri në dhjetë njerëz brenda. Shtëpia ofron çaste relaksimi dhe qetësie për familjarët.

BARSOLETA E DITËS



Si merret vesh që një bionde po thotë diçka inteligjente?
- Kur e fillon fjalinë me: 'Një ditë një mashkull më ka thënë...!'



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00
"X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray



Ne ora 22:00

"M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




DASHI

Sot do ta ndjeni veten të përfshirë në një çështje që ju ka lënduar pa masë. Shumë persona nuk do ta kuptojnë sjelljen tuaj.



DEMI

Po ju tërheq fillimi i ditës dhe po ndiheni dhe ju më mirë se zakonisht. Është koha për të ndërmarrë aktivitete të reja.



BINJAKËT

Sot do të jetë një ditë shpenzimesh për ju. Do të shikoni që lekët do t'ju fluturojnë nga xhepat edhe për gjëra që mbase nuk i keni të nevojshme.



GAFORRJA

Partneri ju ka bërë një surprizë duke ju dhuruar një udhëtim të shkurtër. Do të lumturoheni pa fund dhe po filloni po bëni gati valixhet.



LUANI

Shumë gjëra dhe projekte po diskutohen në tavolinë sot, por nuk keni asnjë gjë konkrete mbi të cilën doni të punoni.



VIRGJËRESHA

Për momentin asnjë person i veçantë nuk ka zgjuar te ju zjarrin e pasionit. Me ndryshimet e fundit prisni të ndryshojë dhe gjendja sentimentale.



PESHORJA

Në fushën profesionale sot do të keni një ndihmë të madhe nga kolegët, pa bashkëpunimin e të cilëve nuk mund të realizoni asgjë.



AKREPI

Sot ndiheni të dhunuar psikologjikisht në ambientin e punës dhe reagimi do të jetë mjaft i fortë. Do të përfshihen edhe persona të tjerë.



SHIGJETARI

Sot do të shpërndani dashuri pa fund në ambientin tuaj familjar. Gjithkush që ju qëndron pranë do ta marrë vëmendjen tuaj.



BRICJAPI

Nuk do të jetë një ditë aspak e qetë kjo e sotmja dhe të gjithë e kërkojnë fajin te ju. Një problem do ta tërheqë vëmendjen më shumë se të tjerët.



UJORI

Keni kurajën t'i mbron argumentet tuaja dhe kjo ju ka bërë të rreshtoheni nga ana e personave të drejtë. Kompromiset mund t'i bëni shumë rrallë.



PESHQIT

Sot dëshironi të merreni vetëm me aktivitete që nuk kanë nevojë për përfshirje shumë të madhe. Dita do të shkojë mirë në çdo aspekt.

Mario Lopezi bëhet sërish baba

Mario Lopez dhe gruaja e tij Courtney Mazza kanë mirëpritur në jetë fëmijën e tyre të tretë, një djalë me emrin Santino Rafael. "Është një djalë. I shëndetshëm dhe djalë i bukur", ka shkruar Mario në rrjetin social "Instagram" bashkë me fotografinë e të porsalindurit. Çifti ka njoftuar se do të bëheshin sërish prindër në janar, por nuk e zbuluan gjininë. Lopez, 45-vjeçar dhe Mazza,



36-vjeçare, u takuan në vitin 2008 dhe më pas u martuan në vitin 2012.

Kryhet autopsia e Cameron Boyce, shkaku i vdekjes nuk dihet

Është kryer një autopsi për ta përcaktuar vdekjen e aktorit të Disney, Cameron Boyce. Më shumë informacione do të dalin pas hetimeve të mëtejshme pasi mjeku nuk ishte në gjendje të arrinte menjëherë në përfundim. "Analisti mjekësor në Los Angeles thotë se autopsia u krye të hënën dhe shkaku i vdekjes është në pritje", ka thënë Brendon Geoffrion nga Entertainment Tonight. Familja e Cameronit tha se ai vdiq në gjumë për shkak të një konfiskimi që ishte një rezultat i një gjendje të vazh-



dueshme mjekësore për të cilën po trajtohej. Aktori ishte vetëm 20 vjeç kur vdiq dhe kishte shumë projekte duke punuar.



Sofia dhe Joe në Itali për përvjetor

Sofia Vergara dhe Joe Manganiello shijuan një drekë gjatë pushimeve të tyre italiane në Amalfi, Itali. Çifti është parë duke ngrënë drekë dhe duke kaluar kohë në një varkë. Sofia

dhe Joe janë me pushime për ta festuar përvjetorin e tyre të pestë si çift. "Vendi im i preferuar me të preferuarin tim", ka shkruar Sofia poshtë një fotografie të postuar në rrjetin social "Instagram".



Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës 03/L-212, Neni 3 i Rregullores për marrëdhënien e punës 01-2991/14, Neni 4 i Udhëzimit Administrativ nr 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Telekomit i Kosovës Sh.A shpall:

KONKURS PUBLIK PËR VENDE PUNE

Titulli i vendit të punës 1. Zyrtar i Financave (3- ekzekutues)

Vendi i Punës: Prishtinë
Data e hapjes: 10.07.2019
Afati i fundit për aplikim: 24.07.2019 në ora 16:00

1. Zyrtar i Financave (3 ekzekutues)

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Monitoron dhe analizon raportet mujore të pasqyrave financiare; ndihmon në përgatitjen dhe analizimin e projeksioneve; ndihmon në përgatitjen e pasqyrave financiare (pasqyrën e të ardhurave, bilancin e gjendjes, rrjedhën e parasë) në baza periodike; merr pjesë në analizimin dhe koordinimin e procesit buxhetor, si pjesë e grupit të sektorit; zhvillon dhe mban marrëdhënien të punës me sektorët tjerë për promovimin e praktikave më të mira të TK-së; përgatit raporte periodike (mujore, tremujore dhe vjetore); respekton praktikat e zakonshme të punës, përfshirë orarin e punës, afatet e raportimit dhe konfidencialitetin e informatave. Kryen punë dhe detyra tjera sipas nevojës së departamentit.

Kualifikimi, përvoja dhe të tjera:

Fakulteti Ekonomik, së paku 2 vite përvojë pune në këtë lami, njohuri rreth fushës së kontabilitetit, njohuri rreth Microsoft Office, Word, Excel, Outlook, të jetë fleksibil në punë, të bashkëpunojë në grup dhe të jetë kooperativë, njohja e gjuhës angleze e preferuar.

Afati i fundit për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit.

Forma e aplikacionit për punësim mund të merret online <http://www.kosovotelecom.com> dhe së bashku me CV-në e detajuar, letër motivuese, dëshmi për punësim dhe kualifikimet, duhet të dorëzohen me e-mail në adresën: hr@kosovotelecom.com.

Afati i fundit për aplikim është data **24.07.2019 në ora 16:00**. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraprirë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në rrethin e ngushtë do t'i nënshtrohen intervistës.



Na osnovu člana 8. Zakona o radu 03/L-212, člana 3. Pravilnika o radnom odnosu, 01-2991/14, člana 4. Admin. Uputstva br. 07/2017, za uređenje postupka konkursa u javnom sektoru, Telekom Kosova a.d. raspisuje:

KONKURS ZA RADNA MESTA

Naziv radnog mesta: 1. Službenik za finansije (3 izvršioaca)

Radno mesto: Priština
Datum raspisivanja konkursa: 10.07.2019.g.
Zadnji rok za prijavu: 24.07.2019.g. u 16:00 časova

1. Službenik za finansije (3 izvršioaca)

Glavni zadaci i odgovornosti:

Prati i analizira mesečne izveštaje finansijskih izveštaja; pruža pomoć prilikom sačinjavanja analiza i planova; pruža pomoć prilikom sačinjavanja finansijskih izveštaja (periodični izveštaj o prihodima, bilanc stanja, protok gotovog novca); učestvuje u analizi i koordinaciji budžetskih postupaka, kao deo grupe sektora; sačinjava i održava radne odnose sa ostalim sektorima za unapređenje nabolje prakse u TK-u; sačinjava periodične izveštaje (mesečne, tromesečne i godišnje); poštuje redovnu radnu praksu, uključujući redovno radno vreme, rokove za izveštavanje i poverljivost informacija. Kryen punë dhe detyra tjera sipas nevojës së departamentit.

Stručna sprema, iskustvo i ostalo:

Završen Ekonomski fakultet i najmanje 2 godine radnog iskustva u ovoj oblasti, poznavanje računovodstva, poznavanje Microsoft Office, Word, Excel, Outlook; fleksibilan u radu; saraduje sa ostalima u grupi; poznavanje engleskog jezika je poželjno.

Zadnji rok za prijavljivanje na konkursu je 15 dana od dana raspisivanja i objavljivanja istog.

Obrazac za prijavljivanje na konkursu, može se preuzeti iz online stranice <http://www.kosovotelecom.com> koji zajedno sa detaljnom poslovnom biografijom (CV), motivacionim pismom, dokazom o zaposlenosti i kvalifikacijama, treba poslati na e-mail adresi: hr@kosovotelecom.com.

Zadnji rok za prijavu na konkursu je **24.07.2019.g. u 16:00 časova**. Prijave poslate nakon predviđenog roka, neće se prihvatiti. Nepotpune prijave na konkursu, biće odbijene.

Samo kandidati iz užeg spiska, biće pozvani na usmeni razgovor.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Karateistët krenohen me medaljet, paralajmëron rezultate edhe në Botëror

Nëntë medaljet e fituara në Kroaci kanë bërë që të gjithë në Përfaqësuesen e Kosovës të shfaqen të kënaqur. Pas këtij suksesi dhe punës së palodhshme që po bëhet nga karateistët e rinj paralajmërohen se medaljet do të rrëmbehen edhe në Kampionatin Botëror. "Jam shumë i kënaqur me paraqitjen e tyre. Këta treguan karakter të fortë. Besojmë shumë se në Kampionatin Botëror që do të mbahet në tetor do të kthehemi me medalje", ka thënë Isak Curri, përzgjedhës i Kosovës në karate



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 KORRIK - Karateistët e rinj të Kosovës kanë shkëlqyer në Kupën e Botës dhe ligën e të rinjve që është mbajtur në Umag të Kroacisë, pasi kanë rryer plot nëntë medalje. Nga medaljet e fituara tri ishin të arta e gjashtë të bronzta. Pjesëmarrëse ishin 69 shtete me 1 155 garues dhe 1 206 paraqitje, kurse 70 shtete në ligën e të rinjve me 2 500 garues dhe 2 578 paraqitje.

Sekretari i Përgjithshëm i Federatës së Karatesë së Kosovës (FKK), Nazmi Gashi, të martën në konferencë për medie ka thënë se ky është një sukses

i madh për Kosovën, pasi konkurrenca ishte mjaft e fortë. "Patëm paraqitje dhe prezantim shumë të mirë të Kosovës ku edhe fituam 9 medalje, 6 prej tyre të bronzta dhe 3 të arta. Luftërat ishin të vështira, por sukseset e mëdha", ka thënë Gashi, i cili ka shfaqur brengën se Përfaqësuesja e Kosovës u përballë edhe një herë tjetër me probleme financiare. "Jemi përballur me probleme financiare si zakonisht, kishim vonesë në pagesa. Kjo garë u realizua me ndihmën e kryetarit të Federatës, donatorëve dhe shokëve tanë", ka shtuar ai.

Në konferencë për medie foli edhe përzgjedhësi Isak Curri, i cili është shprehur i kënaqur me suksesin e

karateistëve të Kosovës në Kroaci, kurse ka shprehur optimizëm se edhe në Kampionatin Botëror, i cili mbahet në tetor, do të korrin suksese të tjera. "Sportistët tanë treguan që kanë punuar shumë me trajnerët, kurse ne si federatë kemi bërë gjithçka që sportistët të përgatiten fizikisht dhe psikikisht për këtë nivel garash. Jam shumë i kënaqur me paraqitjen e tyre. Këta treguan karakter të fortë. Besojmë shumë se në Kampionatin Botëror që do të mbahet në tetor do të kthehemi me medalje. Trajnerët botërorë kanë dhe lënddata, kurse sportistët tanë me punën e trajnerëve të tyre u tregojnë të gjithëve se jemi duke punuar", ka deklaruar Curri.

SHKURT

Istogu 'blindon' Aurorën dhe Blertën

Dy portieret e reprezentacionit të Kosovës, Aurora Shehdadi dhe Blerta Ahmetxhekaj, kanë vazhduar kontratat edhe për dy vjet të tjera me skuadrën më të mirë në vend, kampionen dhe fituesen e Kupës së Kosovës, KHF Istogu. KHF Istogu do të bëjë garë sërish në Evropë dhe synim e ka krijimin e një skuadre stabile. Klubi i Istogut ka njoftuar se shumë shpejt do të zyrtarizohen përforcimet nga jashtë.

Vushtrria transferon Dervishajn

Anëtarja e re e IPKO Superligës, Vushtrria, është duke punuar intensivisht për të qenë skuadër stabile në elitë. Kjo skuadër ka arritur ta rrëmbejë talentin Besfort Dervishaj nga skuadra e Drenicës. "Mesfushori defanziv i talentuar, 20-vjeçari nga Skenderaj, fillon përvojën e re në Vushtri. Ne i dëshirojmë shumë suksese", thuhet në njoftimin e Vushtrrisë. Kjo skuadër ka vazhduar kontratat me Djellon Dragusha dhe Daut Maxhunin, kurse e ka rikthyer edhe Kujtim Pantinën.

'Toki': Muçiqit ia jap dorën për muzikë tallave, jo për futboll

Nënkryetar i FC Prishtina, Afrim Muçiqi, në emisionin "SportShow" ka përjashtuar rikthimin e Afrim Tovërlanit në postin e trajnerit. Ndërsa "Toki" i është kundërpërgjigjur Muçiqit, duke i thënë se "ia jap dorën për muzikë tallave, por jo edhe për futboll". "Po përtoj të merrem me atë teneqexhi, veç me atë foto (të cilën mund ta shikoni më poshtë) ia kujtova se nuk e kanë përjetuar moti. Për muzikë tallave ia jap dorën, por për futboll s'mund të lejoj veten të bie aq poshtë e të merrem me të. Çka të them, po shihet se si i ka punët klubi. Le të thonë çka të dojë, por ky qytet e di mirë cila është e vërtetë. Unë iu dëshiroj suksese e ata le të vazhdojnë si të duan", ka thënë Tovërlanim për "Olle".

I jepet lamtumira e fundit Florijana Ismailit

PRISHTINË, 9 KORRIK - Ceremonia lamtumirës e ndarjes nga Florijana Ismaili, futbolliste e Kombëtares së Zvicrës, që humbi jetën dhjetë ditë më parë në liqenin Como në Itali, është zhvilluar në një sallë sportesh në Worben të Kantonit të Bernit. Në këtë ceremoni të organizuar nga Federata e Futbollit e Zvicrës po marrin pjesë rreth 500 veta, transmeton

"albinfo.ch". Mes tyre ishin edhe bashkëlojtaret e Florijanës të cilat kishin veshur fanellat e klubit YB, në shenjë kujtimi për lojtaren e ndjerë. Janë mbajtur disa fjalë nga personalitete të ndryshme, nga familja dhe miqtë. Mes të tjerëve, një përfaqësues i federatës së përmendur në fjalimin e tij lamtumirës ka thënë: "Është e vështirë të gjenden fjalët për atë që ka

ndodhur. Por, për Florijanën si njeri nuk është e vështirë: ajo ka qenë një vajzë e qeshur, tolerante, e gatshme për të ndihmuar. Ka qenë një shembull, model. Të dashur prindër, ju mund të jeni me të vërtetë krenarë me të". Ceremonia sipas rritit islam është mbajtur nën drejtimin e një imami, ndërsa varrimi është bërë në praninë e një rrethi të ngushtë familjar.



City e huazon Muriqin te Nottinghami

MANCHESTER, 9 KORRIK - Manchester City e ka huazuar reprezentuesin e Kosovës, Arijanet Muriqi, në skuadrën Nottingham Forest, në Championship. Portieri shqiptar kishte disa paraqitje në

Carabao Cup, trofe që e fitoi në fund skuadra e Cityt. Muriqi ishte portieri i dytë në skuadrën e Manchester Cityt, Claudio Bravo ishte i lënduar. Mirëpo City e huazoi te Nottingham Forest për

ta fituar përvojën e duhur. "Të shkoj në Nottingham Forest do të jetë një mundësi për mua që të fitoj përvojë më të madhe në ekipin e parë dhe mezi e pres këtë përvojë të re", ka thënë Muriqi.



Licencohen Federata e Motoçiklizmit dhe e Triathlonit

PRISHTINË, 9 KORRIK - Federata e Motoçiklizmit e Kosovës dhe Federata e Triathlonit e Kosovës janë licencuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ministri Kujtim Gashi priti në këtë takim kryetarët e këtyre federatave, Nuhi Llugaxhiu dhe Vedat Tërmlkollit, me të cilët nënshkroi edhe dy memorandume bashkëpunimi me qëllim të mbështetjes financiare nga ana e MKRS-së me nga 20 mijë euro. Ministri Kujtim Gashi është shprehur i kënaqur me dhënien e licencave për këto dy federata. "Ne jemi të përkushtuar që t'i plotësojmë kushtet e nevojshme për çdo sport që zhvillohet në Kosovë dhe jo vetëm përmes dhënies së licencave për federatat e reja, por edhe përmes mbështetjes financiare për këto federata. Kjo bëhet me qëllim të lehtësimit të punës dhe motivimit të federatave dhe të rinjve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme sportive", ka thënë ministri Gashi. Ndërsa kryetari i Federatës së Motoçiklizmit, Llugaxhiu dhe ai i



Triathlonit, Tërmlkollit, u shprehën të lumtur me dhënien e licencave dhe për nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit për çka edhe e falënderuan ministrin

Gashi. Ata premtuan se do të angazhohen maksimalisht për zhvillimin e këtyre sporteve në vend dhe të talenteve të reja në këto dy sporte.

Formula 1 zbulon projektin e së ardhmes



MILAMI, 9 KORRIK - Pronarët e Formulës 1 asnjëherë nuk kanë hequr dorë nga ideja për ta zhvilluar në Amerikë një garë të dytë. Dhe vendi i përzgjedhur është Miami, qyteti bregdetar i ëndrrave për çdo njeri. Chloe Targett-Adams, drejtoresha e marketingut dhe marrëdhënieve të marketingut në Formula 1, në një intervistë për ESPN konfirmon

këtë ide: "Po punojmë për një projekt afatgjatë". "Ne jemi të bindur se Miami është një qytet që ka shumë potencial për të mirëpritur dhe organizuar një garë të Formulës 1. Një qytet plot jetë dhe një garë këtu do të ishte ideale", ka thënë Adamsi. Gjithsesi, shefja e Formula 1 pranon se nuk është e lehtë, pasi vështirësia më e madhe është gjet-

ja e zonës së duhur ku do të zhvillohet gara. Ideja e saj është të zhvillohet një garë qytetase në rrugët e Miami. "Është e vështirë t'i përshtatësh interesat e investitorëve me ato të komunitetit. Ndaj, duhet gjetur kompromisi i duhur që t'i kënaqë të gjithë, që t'i ulë pakënaqësitë e banorëve të zonës ku mund të zhvillohet gara", ka deklaruar Adamsi.

SHKURT

Avdijaj prezantohet te Trabzonspor

Sulmuesi i Kosovës, Donis Avdijaj, do ta vazhdojë karrierën te Trabzonspor në kampionatin turk. 22-vjeçari është prezantuar te klubi i ri, duke nënshkruar një kontratë trevjeçare me të drejtë rinovimi edhe për një vit tjetër. Sulmuesi së fundmi ishte pjesë e skuadrës holandeze Uillem II, teksa u përjashtua për arsye disiplinore. Në një prononcim për mediat pas firmës me klubin e ri, ai tha: "Jam shumë i lumtur që kam ardhur te një klub me tifozë madhështorë si Trabzonspor, ku mund t'i tregoj aftësitë e mia. Erdha këtu për t'i kënaqur këta tifozë të çmendur. E di mirë kualitetin e madh të ekipit, gjithashtu jam në dijeni se lojtarëve të rinj u jepet mundësia ta tregojnë veten këtu, prandaj kam zgjedhur Trabzonsporin. Falënderoj Zotin, pastaj familjen dhe miqtë e mi", ka thënë Avdijaj.

Higuaini refuzon largimin nga Juventus

Sulmuesi Gonzalo Higuain nuk është i interesuar t'i bashkohet skuadrës së Romës apo ndonjë klubi tjetër, pasi beson se mund ta bindë Maurizio Sarrin te Juventus, raporton "Sky Sport Italia". Argentinasi pas huazimit te Milani dhe Chelsea është rikthyer sërish te "Zonja e Vjetër". Ky vendim i Higuainit nuk u ka pëlqyer aspak drejtuesve te Juves, pasi ata planifikojnë transferimin e Mauro Icardit (Inter) ose Romelu Lukaku (Manchester United).

Bayerni interesohet për Henrichs

Pas "Kicker" edhe "L'Equipe" ka konfirmuar se Bayern Muncheni është i interesuar për Benjamin Henrichs. Sipas gazetës franceze "bavarezët", ofrojnë 25 milionë euro për mbrojtësin e krahut, ndërsa Monaco kërkon 35 milionë. Priten negociata mes klubeve. Një interesim i mundshëm do të konfirmonte një riorganizim të mbrojtjes, në të cilën Benjamin Pavard do të shihej vetëm si mbrojtës qendër bashkë me Sulen dhe Hernandezin, ndërsa Henrichs do të ishte zëvendësuesi i Alabas dhe Kimmich.

Neymari mund të largohet nga PSG-ja

Drejtori sportiv i Paris Saint-Germain, Leonardo, ka njoftuar se janë të gatshëm ta shesin yllin brazilian, Neymar. "Është e qartë për të gjithë. Në futboll, ju thoni një gjë dhe pastaj një gjë tjetër pastaj tjetër. Është e pabesueshme, por kështu është. Ne kemi folur me përfaqësuesit e tij. Pozicioni i tyre është i qartë, por tani ekziston vetëm një gjë që është e sigurt: ai ka një kontratë trevjeçare me ne, por Neymari mund të largohet nëse marrim ofertën e duhur", ka thënë Leonardo.

Podolski, afër rikthimit në Kombëtaren e Gjermanisë

Lukas Podolski është shumë pranë rikthimit në kombëtaren gjermane. Mëngjarashi mund të përzgjidhet si një ndër tre lojtarët mbi moshën 23 vjeç në skuadrën që Gjermania do të dërgojë në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020". Ka qenë vetë futbollisti gjerman që e ka pohuar këtë gjë në një intervistë për medien gjermane "Express": "Do të ishte një nder i madh nëse do të jem pjesë e skuadrës së Gjermanisë në lojërat olimpikë. Kam krijuar një lidhje të fortë me Japoninë në vitet e fundit. 34-vjeçari luan prej dy vjetësh në Japoni me skuadrën e Visel Kobe. Podolski ka grumbulluar 130 aktivizime me përfaqësuesen gjermane, ku ka shënuar 49 gola.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit të Komunës

Udhëheqësi i Personelit/Rukovodilac Personalna/Head of Personnel

Nr. 111/01-0042035/19

Skenderaj, më 09 Korrik 2019.

Udhëheqësi i Personelit, duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11, paragrafi 1 dhe 2, nenin 12 paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Shërbimin Civil nr.03/L-149, dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në SHC si dhe pas autorizimit për shpalljen e konkursit nga MAP përmes SIMBNJ nga DASHC për pozitat e lira për një, Zyrtar Ligjor 2, LI/060 / JP00039758, Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 2 KG/040 / JP00039829, Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim UNM/150 / JP00039828 me 9 Korrik 2019, vendosi të shpallë këtë:

KONKURS

Për plotësimin e tre (3) vendeve të lirë të punës në organet e Administratës të Komunës së Skenderajt.

Emri i Institucionit: Komuna e Skenderajt—Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

Pozita e punës: Zyrtar Ligjor 2.

Numri i Ekzekutuesve: 1.

Kodi Buxhetor: 65315.

Kategoria funksionale: Profesional 2.

Grada e vendit të punës: Koeficienti 7.

Lloji i vendit të punës: I karrierës, më orar të plotë(40)orë.

Raporton: të Drejtorit për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

Vend ndodhja: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Komuna Skenderaj

-Përshkrimi i detyrave të punës: Harton akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtarie e institucionit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, siguron përputhshmërinë e projektligjeve dhe akteve tjera nënligjore me legjislacionin në fuqi në Kosovë, kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të është sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik si dhe të jenë identike në të tri gjuhët zyrtare, bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikëqyrësi dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim, sipas kërkesës dhe sipas udhëzimeve të nivelit më të lartë jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projektmarrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera, bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit, Kujdeset që aktet ligjore të jenë në përputhje me legjislacionin aktual në fuqi dhe rregulloret aktuale, kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi

Kualifikimi: Përgatitja profesionale: Diplome Universitare se paku 2 vite përvojë pune.

- Përveç kushteve të parapara me ligj, kandidati duhet t'i plotësoj kushtet si në vijim:
 - Një CV të shkurtër.
 - Të këtë shkathësi dhe aftësi profesionale për këtë vend pune.
 - Kandidati duhet të jetë i gatshëm të punojë nën presion dhe në shoqëri multietnike.
 - Shkathësi dhe aftësi të mira komunikimi.
 - Njohja e gjuhëve zyrtare.
 - Kohëzgjatja e punës provuese 12 muaj, në bazë të Rregullores të MAP/DASHC nr. 02/2011.
- Të interesuarit për këtë vend pune, aplikacionit duhet t'ia bashkëngjisin këto dokumente:**
- Diplome Universitare –Fakulteti Juridik se paku 2 vite përvojë.
 - Dëshmi për përvojën e punës.
 - Certifikata e lindjes.
 - Kopjen e letërnjoftimit të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës.
 - Certifikatën që nuk jeni të dënuar dhe nën hetime nga Gjykata.
 - Kandidati/ja që pranohet në vendin e punës duhet të sjellë certifikatën mjekësore .

Emri i Institucionit: Komuna e Skenderajt- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm

Pozita e punës: Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim

Numri i Ekzekutuesve: 1.

Kodi Buxhetor: 48023.

Kategoria funksionale: Profesional 2

Grada e vendit të punës: Koeficienti 7.

Lloji i vendit të punës: I karrierës, më orar të plotë(40)orë.

Raporton: të Drejtorit për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm.

Vend ndodhja: Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm, Komuna Skenderaj.

-Përshkrimi i detyrave të punës: Analizon rregulloret, standardet dhe procedurat në fushën e planifikimit dhe zhvillimit dhe rekomandon përmirësimin e proceseve nëse është e nevojshme, shqyrton dhe vendos lidhur me kërkesat e pranura për planifikim, në raste të caktuara del në terren për shikim dhe incizim të gjendjes faktike, analizon gjendjen në terren dhe në bazë të gjendjes reale i propozon sektorit të planifikimit dhe zhvillimit urban hapat e mëtejme të zgjerimit të zonës urbane, koordinon dhe harmonizon dokumentet e planifikimit hapësinor të nivelit lokal me atë qëndror, përkatësisht me Planin Hapësinor të Kosovës dhe dokumentet tjera strategjike sektoriale, bashkëpunon në hartimin e dokumentacionit lidhur me planifikimin hapësinor, si të Planit Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale Komunale, Planeve Rregulluese të Hollësishme brenda territorit të Komunës dhe planeve tjera nga legjislacioni në fuqi, Përcjellë dhe zbaton ligjet dhe rregulloret nga fusha e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, ndihmon udhëheqësin e sektorit në të gjitha punët nga përgjegjësia e sektorit kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë kohë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi

Kualifikimi: Përgatitja profesionale: Diplome Universitare se paku 2 vite përvojë pune.

- Përveç kushteve të parapara me ligj, kandidati duhet t'i plotësoj kushtet si në vijim:
 - Një CV të shkurtër.
 - Të këtë shkathësi dhe aftësi profesionale për këtë vend pune.
 - Kandidati duhet të jetë i gatshëm të punojë nën presion dhe në shoqëri multietnike.
 - Shkathësi dhe aftësi të mira komunikimi.
 - Njohja e gjuhëve zyrtare.
 - Kohëzgjatja e punës provuese 12 muaj, në bazë të Rregullores të MAP/DASHC nr. 02/2011.
- Të interesuarit për këtë vend pune, aplikacionit duhet t'ia bashkëngjisin këto dokumente:**
- Diplome Universitare –Fakulteti Ekonomik, Shkencat Politike se paku 2 vite përvojë.
 - Dëshmi për përvojën e punës.
 - Certifikata e lindjes.
 - Kopjen e letërnjoftimit të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës.
 - Certifikatën që nuk jeni të dënuar dhe nën hetime nga Gjykata.
 - Kandidati/ja që pranohet në vendin e punës duhet të sjellë certifikatën mjekësore .

Emri i Institucionit: Komuna e Skenderajt—Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

Pozita e punës: Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 2.

Numri i Ekzekutuesve: 1

Kodi Buxhetor: 65315.

Kategoria funksionale: Profesional 2

Grada e vendit të punës: Koeficienti 7

Lloji i vendit të punës: I karrierës, më orar të plotë(40)orë.

Raporton: të Drejtorit për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

Vend ndodhja: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Komuna Skenderaj

Vend ndodhja: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Komuna Skenderaj

-Përshkrimi i detyrave të punës: Ndihmon në hartimin dhe zhvillimin e planeve të punës në pajtim me mbikëqyrësin në zbatimin e detyrave të punës, pranon dhe regjistron të gjitha llojet e kërkesave për bartjen e pronës në bazë të kontratës për shitblerjen dhe udhëzon palet për plotësim, regjistron të drejtat e pronësisë së paluajtshëm, tokave, objekteve në regjistrin kadastral dhe bënë regjistrime, bënë regjistrimin e të së drejtës pronësore sipas procedurave dhe zbaton të gjitha dispozitat positive në fuqi lidhur me regjistrin e pronës, përcjell të gjitha ndërrimet në sipërfaqën e tokës, duke harmonizuar gjendjen reale në terren me gjendjen operative kadastrale, bënë rregullimin e të dhënave të pasurisë së paluajtshme në terren me qëllim të regjistrimit në sistemin e kadastrit dhe rregullimimm e kufijve të pasurive të tyre, përgadit dokumentet e nevojshme për infrastruktur rrugore përfshir inqizimet gjeodezike të gjitha profileve, kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë kohë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Kualifikimi: Përgatitja profesionale: Diplome Universitare se paku 2 vite përvojë pune

- Përveç kushteve të parapara me ligj, kandidati duhet t'i plotësoj kushtet si në vijim:
 - Një CV të shkurtër.
 - Të këtë shkathësi dhe aftësi profesionale për këtë vend pune.
 - Kandidati duhet të jetë i gatshëm të punojë nën presion dhe në shoqëri multietnike.
 - Shkathësi dhe aftësi të mira komunikimi.
 - Njohja e gjuhëve zyrtare.
 - Kohëzgjatja e punës provuese 12 muaj, në bazë të Rregullores të MAP/DASHC nr. 02/2011.
- Të interesuarit për këtë vend pune, aplikacionit duhet t'ia bashkëngjisin këto dokumente:**
- Diplome Universitare –Fakulteti i Gjeodezisë, Fakulteti i Gjeografisë se paku 2 vite përvojë.
 - Dëshmi për përvojën e punës.
 - Certifikata e lindjes.
 - Kopjen e letërnjoftimit të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës.
 - Certifikatën që nuk jeni të dënuar dhe nën hetime nga Gjykata.
 - Kandidati/ja që pranohet në vendin e punës duhet të sjellë certifikatën mjekësore .

“Shërbimi Civil i Kosovës është në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës, i cili i mirëpret të gjitha aplikacionet nga meshkujt dhe femrat të të gjitha komuniteteve të Kosovës” Aplikacionet mund të merren në Zyrën Pritëse (QSHQ) të Komunës së Skenderajt. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse (QSHQ) të Komunës së Skenderaj, në kopje dhe mbetet në arkiv nuk kthehet, konkursi është i hapur në afat prej 15 ditësh, që nga dita e shpalljes së këtij konkursi në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditshme dhe në web-faqen e Komunës. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që vijnë pas afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen. Konkursi do të shpallet në të dy gjuhët.

Udhëheqësi i Personelit

Armend Gruda



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

ATK, ju rikujton se Vendimi Shpjegues Publik Nr. 02/2019 përcakton trajtimin tatimor të Kontratave Afatgjate Ndërtimore

Administrata Tatimore e Kosovës, ju rikujton se në muajin shkurt/2019 ka nxjerrë Vendimin Shpjegues Publik Nr. 02/2019 për trajtimin tatimor të kontratave afatgjate ndërtimore.

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është që të sqaroj trajtimin tatimor për aspekte të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimit në të Ardhura Personale (TAP) dhe Tatimit në të Ardhura të Korporatave (TAK), të kontratave afatgjate ndërtimore.

Ky Vendim Shpjegues Publik vlen për personat e angazhuar në aktivitetet e ndërtimit, gjegjësisht tatimpaguesit të cilët merren me projektet dhe kontratat afatgjate të ndërtimit.

Vendimin Shpjegues Publik Nr. 02/2019 për trajtimin tatimor të kontratave afatgjate ndërtimore, mund ta gjeni në ueb faqen e ATK-së www.atk-ks.org në linkun *Publikime – Shpjegimet Publike*.

ATK, në bashkëpunim me FMN, në implementim të Projektit “Përbushja në Sektorin e Ndërtimitarisë”!

Administrata Tatimore e Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Udhëheqësi i Personelit-Kabinet Predsendika-Kancelarija Personala
Mayor's office staff leader

Br. 11/01-0042035/19
Skenderaj, 09 Juli 2019 g.

Rukovodilac personala na osnovu člana 3, stav 2, člana 11, stav 1 i 2, člana 12, stav 3, člana 18 stav 1, člana 20, stva 1 i 2, Zakona o Javnoj Službi Kosova br. 03/L-149, Pravilnika br. 02/2010, za procedure regrutacije u javnoj službi, kao i ovlašćenju za objavljivanje konkursa od MJA preko ISMLJR iz DACS, za slobodno radno mesto Pravni Službenik 2, LI/060 JP00039758, Službenik za Kadastar i Geodeziju 2 KG/040/JP00039829, Službenik za Planifikaciju i Razvoj, UNM/150/JP39828, 09 Jula 2019 godine je odlučio da objavljuje sledeći:

**KONKURS
O POPUNJAVANJE TRI (3) SLOBODNA RADNA MESTA U ORGANIMA
SAMOUPRAVE SKENDERAJ**

- Ime Institucije: Opština Skenderaj- Direkcija za Geodeziju, Kadastar i Imovinu;
- Naziv radnog mesta: Pravni Službenik 2;
- Broj izvršilaca: 1
- Budžetski Kod: 65315,
- Faunkcionalna Kategorija :Profesional 2
- Stepen radnog mesta: koeficijent 7
- Tip radnog mesta: KARIJERE puno radno vreme (40) časova,
- Raportira: Direktor za Geodeziju, Kadastar i Imovinu;
- Sedište: Direkcija za za Geodeziju, Kadastar i Imovinu, Opština Skenderaj

Opis Radnih Zadataka: Izrađuje normativne akte, kao i druge pravne akte koja proizlazu od delatnosti osnovne institucije, osigurava uskladenosti nart-zakona, kao i drugih podzakonskih akata sa zakonskim odredbama na snazi, dužan je da forma i dizajn normativnog akta da bude što pravni i što manje grešaka na jezičnom smislu, kao i da bude indentičan na tri službena jezika. Izvrši istraživanja i analize informacija za dotične teme određene od strane nadzornika, kao i identifikira opcije ili pitanja za razmatranje po zahtevu i upustvima višeg nivoa, daje pravne predloge, kao i izvršava izradu nart-ugovora, nart-oduka i nart-drugih službenih akata, saraduje i komunicira sa ostalim jedinicama unutar i van zakonskih odredaba na snazi. Stara se da izrađene akte da budu u potpunom skladu zakonskim odredbama na snazi i pravilnicima na snazi, izvršava i durfe poslove u skladu sa svrhom radnog mesta, koj se mogu tražiti u međuvremenu od strane nadzornika.

Kavifikacija: Universitetska diploma, najmanje 2 godine radnog iskustva

- Osim opštih uslova predviđene zakonom, kandidat mora ispuniti i sledeće uslove:
- Kratak CV;
- Da poseduje veštine i profesionalne sposobnosti za ovo radno mesto;
- Kandidat mora biti spreman da radi po pritiskom na multietničkoj društvi;
- Dobre sposobnosti za komunikaciju;
- Poznavanje službenih jezika;
- Trajanje probnog perioda 12 meseca, Pravilnika MJS/DACS br. 02/2011 za probni rad javnih službenika.

Zainteresovanih za ovo radno mesto, aplikaciji treba priložiti i sledeću dokumentaciju:

- Universitetska diploma, Pravni Fakultet najmanje 2 godine radnog iskustva;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Rodjeni izvod;
- Kopiju lične karte izdate od MUP-a Republike Kosova;
- Uverenje da nije kažnjen niti pod istragom od nadležnog Suda;
- Kandidat/ kinje koja se prima na ovo radno mesto mora doneti i Lekarsko Uverenje.

- Ime Institucije: Opština Skenderaj- Direkcija za Ekonomski Razvoj, Preduzeštvo, Inovaciju i Turizam;
- Naziv radnog mesta: Službenik za Planifikaciju i Razvoj;
- Broj izvršilaca: 1
- Budžetski Kod: 48023,
- Faunkcionalna Kategorija :Profesional 2
- Stepen radnog mesta: koeficijent 7
- Tip radnog mesta: KARIJERE puno radno vreme (40) časova,
- Raportira: Direktor Direkcije za Ekonomski Razvoj, Preduzeštvo, Inovaciju i Turizam;
- Sedište: Direkcije za Ekonomski Razvoj, Preduzeštvo, Inovaciju i Turizam, Opština Skenderaj

